**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR INFORMACION NË FUSHËN E MJEDIST DHE TURIZMIT

## JANAR- SHTATOR 2023

## Janar 2023

| Nr. (1) | Data e regjistrimit të kërkesës (2) | Objekti (3) | Data e kthimit të përgjigjes (4) | Përgjigja(5) | Statusi i kërkesës (6) | Tarifa (7) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 17.01.2023 | Kërkesë për informacion: Në datën **1 Shtator 2021**, Kryeministri Edi Rama në një njoftim publik në mediat sociale (gjendet në këtë link | 30.01.2023 | 1. Është hartuar projektligji "Për menaxhimin e integruar te zonës bregdetare". Me datë 17.06.2020 është publikuar për konsultim me publikun. Është konsultuar drafti me institucionet e tjera të përfshira ne proces.<br>Me date 15.04.2021, nëpërmjet sistemit e-aktet, projektligji “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare” së bashku me relacionin shoqërues është kthyer nga Kryeministria për "rivlerësim te nismës" në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | https://www.facebook.com/ediramaal/videos/548260516447779 ) ka njoftuar se shumë shpejt do të propozohej një ligj i ri për menaxhimin e vijës bregdetare, në vijim të operacionit “Bregdeti Ynë”.<br><br>Lidhur me këtë çështje kërkoj informacion se në çfarë faze është ky projektligj (Në fazën e hartimit, konsultimit publik, në Kuvend dhe pret miratimin apo është miratuar)? Çfarë parashikohet në këtë ligj për ndërtimet pa leje që kanë zaptuar hapësira publike në vijën bregdetare? | | Aktualisht është stopuar nisma për shkak te vlerësimit te kompetencave te Agjencisë Kombëtare te Bregdetit ne lidhje me menaxhimin e gjithë zonës bregdetare.<br><br>2. Projektligji ka për qëllim menaxhimin e integruar të zonës bregdetare, garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të saj, në harmoni me planin e përgjithshëm kombëtar si dhe me planin sektorial kombëtar te turizmit, nxitjen e aktiviteteve dhe veprimtarive për mbrojtjen, administrimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit në zonën bregdetare si dhe përcaktimin e institucioneve përgjegjëse, për administrimin e kësaj zone.<br>Objektivat që synohen të arrihen përmes miratimit të këtij projektligji dhe zbatimit të tij janë: (i) garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm të zonës bregdetare si dhe sigurimi i mbrojtjes dhe zhvillimit racional; (ii) përcaktimi për herë të parë i kufijve të bregut të detit dhe brezit të zhvillimeve të qëndrueshme; (iii) dhënia e një statusi të veçantë juridik zonës bregdetare; (iv) përcaktimi i bregut të detit si pronë e patjetërsueshme; (v) ndalimi i ndërtimeve në bregun e detit si dhe disiplinimi i ndërtimeve në brezin e zhvillimeve të kontrolluara në harmoni me bregun e detit. | | |
| 2. | 18.01.2023 | Kërkesë për informacion për relacionet e projekt vendimeve: 59 | 30.01.2023 | Kthyer përgjigje bashkëlidhur informacionin e kërkuar. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 10.10.22 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", të ndryshuar” 691 26.10.22 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 360, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”” 694 26.10.22 “Për ndryshimin e statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemit natyror/ligatinor "Pishë Poro-Nartë" nga "Rezervat Natyror | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | i Menaxhuar " në "Peizazh i Mbrojtur" dhe heqjen e statusit "Zonë e Mbrojtur" të sipërfaqes së pakësuar" 888 27.12.22 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre" 889 27.12.22 "Për miratimin e rregullores për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar" | | | | |
| 3. | 18.01.2023 | Kërkesë për informacion: 1. A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat | 30.01.2023 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse gjatë vitit 2022, në mbështetje të pikës 8, të nenit 31, të Ligjit nr.93/2015, "*Për turizmin*" dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | jofitimprurëse (OJF) gjate vitit 2022? 2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qene forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.) 3. Sa OJF kane aplikuar për mbështetje financiare gjate vitit 2022? Ju lutem, specifikoni sipas formës se mbështetjes, nëse ka patur me shume se një forme. 4. Sa OIF kane përfituar nga kjo mbështetje? Ju lutem, specifikoni sipas formës se mbështetjes nëse ka patur me shume se një forme 5. Cila ka qene buxheti i disbursuar për organizate dhe ne total? Ju lutem, specifikoni sipas formës nëse ka patur me shume se një tone 6. Keni ofruar mbështetje jo financiare gjate vitit 2022? Cila është baza ligjore rregullatorë qe rregullon këtë forme mbështetjeje? 7. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, sa OIF kane përfituar nga | | Ministrave nr. 281, datë 13.04.2016 “*Për caktimin e kritereve dhe afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetje financiare në fushën e turizmit*”.<br>Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.04.2016 dhe nëpërmjet Thirrjes për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit, për vitin 2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet fondeve të parashikuara në buxhetin e shtetit, financon projekte studimi, promovimi dhe edukimi apo modele inovative të produkteve turistike, në funksion të turizmit.<br>Përsa i përket thirrjes se projektpropozime për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit, kanë aplikuar në total 90(nëntdhjetë) OJF.<br>Përsa i përket thirrjes së projektpropozime për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit, kanë përfituar 23 (njëzetë e tre) OJF.<br>Në zbatim të pikës 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.04.2016 “*Për caktimin e kritereve dhe afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetje financiare në fushën e turizmit*”, për realizimin e projekteve konkurruese turistike, skema e financimit, për secilin nga subjektet e shpallura fituese, mbulon deri në 50% të kostove të pranuara e të miratuara nga MTM. 23 (njëzetë e tre) OJF përfituese nga thirrjet e projektpropozimeve në fushën e turizmit kanë përfituar në total 45,399,450 Lekë.<br>Gjatë vitit 2022 janë realizuar 6 proceduara te konsultimit me publikun bazuar në zbatimin e përcaktimeve të ligjit nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)” për shprehjen e qëndrimit mbi nevojën ose jo te realizimit të procesit të VSM-së për bashkitë Kukës, Dibër, Dimal, Vau i Dejës, Malësi e Madhe dhe Mirditë. Për pjesëmarrje në konsultim përveç ministrive te linjës janë njoftuar | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kjo mbështetje? Cili ka qene lloji i mbështetjes jo financiarë te ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)? 8. Sa është numri i konsultimeve publike te realizuara nga institucioni juaj gjate vitit 2022? 9. A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 10. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 11. Sa OJF kane marre pjese ne konsultime publike te organizuara nga Institucioni juaj? 12. Sa përqind (%) e projektligjeve I akteve nënligjore te hartuara nga institucioni juaj janë si rezultat i konsultimeve me OJF-te? 13. Ajane te përfshire përfaqësues te OJF-ve ne organe këshillimore te institucionit tuaj? Nëse | | nëpërmjet shkresave zyrtare dhe e-mail-it, Kryetarët e Bashkive kufitare te bashkisë qe ka propozuar ndryshim te PPV, Këshillit e Qarkut, Prefektura, dhe grupe te interesit si organizata mjedisore te ndryshme.<br>gjithashtu janë zhvilluar konsultime me publikun edhe për projektligjet dhe projekt vendimet e mëposhtëm, te cilat kane qene te publikuara dhe në faqen e konsultimeve me publikun, ti cilat janë si më poshtë vijon:<br>Vendimin " për ndryshimin e statusit dhe sipërfaqes të ekosistemit natyror ligatinor “Nartë – Pishë Poro” nga rezervat natyror i menaxhuar në “peizazh i mbrojtur” dhe heqjen e statusit zonë e mbrojtur të sipërfaqes së pakësuar.<br>Vendimin “për shpalljen e ekosistemit natyror detar-bregdetar të gjirit Porto Palermos “park natyror”, kategoria iv.<br>Për amendimin e ligjit “Për menaxhimin e integruar te mbetjeve”,<br>“Për ndalimin e qeseve plastike”.<br>Gjithashtu është zhvilluar konsultim me Bashkitë për projektvendimin për amendimin "Për mbetjet spitalore".<br>Projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162, datë 4.12.2014 “për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar.<br>Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 27, datë 17.3.2016 “Për menaxhimin e kimikateve”.<br>Projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 155/2020 “për ndryshimet klimatike” të ndryshuar.<br>Projektvendimi “”Për miratimin e rregullores për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar”,<br>Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vkm nr. 360, datë 29.4.2015 “për miratimin e listës së | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PO, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë te përfshire ne to? 14. A janë përfshirë OJF ne grupet e punës se ngritura te institucionit tuaj? Nëse PO, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë te përfshire ne to? 15. A është trajnuar stafi juaj mbi veprimtarinë dhe funksionimin e OJF-ve? Nëse po, sa punonjës janë trajnuar? 16. A ka licencuar institucioni Juaj OJF qe ofrojnë shërbime te caktuara? Nëse po, sa OJF janë licencuar? Për çfarë shërbimesh janë licencuar? | | ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre””.<br>Vendimin " për ndryshimin e statusit dhe sipërfaqes të ekosistemit natyror ligatinor “Nartë – Pishë Poro” nga rezervat natyror i menaxhuar në “peizazh i mbrojtur” dhe heqjen e statusit zonë e mbrojtur të sipërfaqes së pakësuar. Sa i përket procesit të konsultimit publik të këtij projektvendimi, pjese e konsultimeve publike për rishikimin e kufijve te zonave te mbrojtura, sqarojmë se, gjatë këtij procesi janë zhvilluar 44 takime e konsulta, në të 12 qarqet e vendit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar konsultimit me grupet e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e botës akademike. Gjatë gjithë këtyre takimeve janë mbledhur një numër i madh propozimesh të rëndësishme për rishikimin, ndryshimin apo zgjerimin e kufijve të zonave të mbrojtura si dhe shpalljen e zonave të reja të mbrojtura. Këto mendime e sugjerime të ardhura, janë reflektuar në mënyrën më të mirë të mundshme në ketë vendim.<br>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka patur Koordinator për Informimin Publik, znj. Gerzheta Akshia, informacioni në linkun bashkëlidhur. https://turizmi.gov.al/programi-i-transparences-2-2/<br>Bëjmë me dije se, znj. Akshia është larguar nga detyra në datën 17.01.2023 dhe MTM është në fazën e miratimit të Koordinatorit të ri për Informimin Publik, informacioni i të cilit do të publikohet në faqen zyrtare të MTM-së. | | |
| 4. | 19.01.2023 | Kërkesë për informacion: A ka Ministria e Mjedisit | 31.01.2023 | Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka një plan investimi për sipërfaqet e gjelbra, ku nëpërmjet punimeve (mbjellje fidanë pyjore) edhe për vitin 2023 do | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | një plan veprimi për investimet e gjelbra ne Shqipëri? Nëse po, ju lutem me dërgoni një kopje. | | te vazhdoje procesin e mbjelljes se fidanëve pyjor në zonat e mbrojtura me rreth 2000 fidanë. | | |
| 5. | 19.01.203 | Kërkesë për informacion: A ka Ministria e mjedisit një plan veprimi mjedisore kombëtar për zonat urbane?<br><br>A ka Ministria një plan ne zbatim te aplikuar për qytetin e Shkodrës?<br><br>Çfarë parashikon ky plan?<br><br>Kërkoj te me vihet ne dispozicion një kopje e secilit plan. | 24.01.2023 | https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Veprimit_Qershor-2019_-1.pdf<br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/profili_kombetar_per_menaxhimin_e_kimikateve_2012_Al-1.pdf<br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-505-2018-NOQ.pdf<br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-412-2019-menaxhimi-i-ajrit.pdf<br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/Vendim-2020-05-27-418_Per-miratimin-e-Dokumentit-te-Politikave-strategjike-dhe-te-Planit-Kombetar-per-menaxhimin-e-Integruar-te-Mbetjeve-1.pdf<br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike_AL.pdf<br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-814-2019-per-pyjet-ne-Shqiperi.pdf<br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike-per-Mbrojtjen-e-Biodiversitetit.pdf | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Ndërsa planet e zbatimit për njësit e qeverisjes vendore bëhen nga bashkitë. | | |
| 6. | 20.01.2023 | Kërkesë për informacion: Në periudhën 2017-2022, sa hotele ka klasifikuar Ministria e Turizmit me 5 yje në Republikën e Shqipërisë, në bazë të VKM Nr.730, datë 20.10.2016,dhe akteve nënligjore pasardhëse në këtë fushë.<br><br>2. Kërkoj të më vihet në dispozicion lista e hoteleve të klasifikuara me 5 yje deri në datën 31.12.2022 | 24.01.2023 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka klasifikuar si hotele me 5 yje, 7 (shtatë) struktura akomoduese.<br>Listën e tyre e gjeni si vijon:<br>• Hotel "The Plaza Tirana"<br>• Hotel "Marina Bay"<br>• Hotel "Mak Albania"<br>• Hotel " Lot Boutique"<br>• Hotel "MK Hotels"<br>• Hotel "Radisson Collection Morina Hotel Tirana"<br>• Hotel "SPV Lura" | Përfunduar | 0 |
| 7. | 23.01.2023 | Kërkesë për informacion : Se bashku me Fondin Shqiptar te Zhvillimit jemi duke zbatuar projektin *"Zhvillimi i Data bazës së Rrjetit Rrugor Rajonal dhe Lokal, Vlerësimi* | 24.01.2023 | Në vijim të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se informacionin e kërkuar e keni në link-et bashkëlidhur dhe në tabelën attach.<br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Lista-e-agjencive-te-udhetimit.pdf<br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/Lista-e-operatoreve-turistike.pdf | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *dhe Prioritizimi i Investimeve"*, i cili synon krijimin e një inventari te plote te rrjetit rrugor rajonal dhe lokal ne te gjithë Shqipërinë.<br>Ne kuadër te këtij projekti, na nevojiten disa te dhëna mbi sektorin e turizmit te tilla si lista e strukturave akomoduese, numri përkatës i shtretërve për strukture, rëndësia e destinacioneve turistike, numri i bizneseve turistike aktive etj.<br><br>A ekziston një data bazë e tille te dhënash mbi sektorin e turizmit qe mund ta ndani me ne? | | https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Lista-me-subjektete-e-certifikuara-te-agroturizmit.pdf<br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Lista-e-subjektete-me-Certifikaten-Parapake-te-Agroturizmit.pdf<br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/Lista-e-strukturave-akomoduese-te-kategorizuara.pdf<br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/Lista-e-Operatoreve-te-Turizmit-Detar-PDF.pdf | | |
| 8. | 23.01.2023 | Kërkesë për informacion: Duke qenë se ka disa vendime mbi zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar të | 23.01.2023 | Deleguar te Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, kthyer përgjigje nga AKZM | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Tomorit dhe shfuqizime te tyre nga Gjykata, ju lutem mund të më siguroni vendimin aktualisht ne fuqi, ku mbështetet zgjerimi i Parkut Kombëtar te Tomorit, siç parashikohet p.sh. ne vendimin nr.611, dt.11.9.2019. Me thoni është ky VKM përfundimtar, apo te tjerë dhe a është ne fuqi ai qe te jemi te sakte me kuadrin ligjor si fillim.<br><br>2. Argumentimin mjedisor ku mbështetet vendimi për ta zgjeruar Parkun Kombëtar te Tomorit.<br><br>3. Çfarë kufizimesh zbatohen ne një zone ZPT ku zbatohet shkalla e dyte e mbrojtjes? Çfarë ndalohet dhe çfarë lejohet ne një zone te tille, siç është zona | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shtese e Parkut Kombëtar te Tomorit?<br><br>4. Dokumentin e Planit Shtese te Menaxhimit te Sipërfaqes se Zgjeruar si pjese e Planit te Menaxhimit te Parkut Kombëtar te Tomorit, hartuar nga MTM ne bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore dhe vendore.<br><br>5. Cilat janë masat e marra nga MTM për rehabilitimin e sipërfaqes se përfshirë ne Park Kombëtar ne Tomor e cila edhe aktualisht, është jashtëzakonisht e dëmtuar nga aktiviteti i guroreve?<br><br>6. Ju lutem jepni një sqarim cili është shpjegimi qe një sipërfaqe përfshihet ne Park Kombëtar dhe | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | lihet si gërmadhe, vite pas këtij vendimi? | | | | |
| 9. | 27.01.2023 | Kërkesë për informacion: Vendimet e “Komitetit te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve” te mbledhjes se mbajtur me date 11 janar 2022<br><br>2- Procesverbalin e mbledhjes Komitetit te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve te datës 11 janar 2022 | 31.01.2023 | Kthyer përgjigje bashkëlidhur informacionin e kërkuar. | Përfunduar | 0 |
| | | | | | | |

## Shkurt 2023

| Nr. (1) | Data e regjistrimit të kërkesës (2) | Objekti (3) | Data e kthimit të përgjigjes (4) | Përgjigja(5) | Statusi i kërkesës (6) | Tarifa (7) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10. | 6.02.2023 | Kërkesë për informacion: 1. Kompanitë e pajisura me licencë të tipit "III.2.B" për vitin 2017 dhe vendimin përkatës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.<br><br>2. Kompanitë e pajisura me licencë të tipit "III.2.B" për vitin 2018 dhe vendimin përkatës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.<br><br>3. Kompanitë e pajisura me licencë të tipit "III.2.B" për vitin 2019 dhe vendimin përkatës nga Ministria | 14.02.2023 | Kthyer përgjigje bashkëlidhur informacionin e kërkuar. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | e Turizmit dhe Mjedisit.<br><br>4. Kompanitë e pajisura me licencë të tipit “III.2.B” për vitin 2020 dhe vendimin përkatës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.<br><br>5. Kompanitë e pajisura me licencë të tipit “III.2.B” për vitin 2021 dhe vendimin përkatës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.<br><br>6. Kompanitë e pajisura me licencë të tipit “III.2.B” për vitin 2022 dhe vendimin përkatës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. | | | | |
| 11 | 15.02.2023 | Kërkesë për informacion: Pse u ndërpre projekti i vitit 2015 ku premtohej Ri natyralizimi i Kodrës | 27.02.2023 | Ne lidhje me pyetjen e pare se: "Pse u ndërpre projekti i vitit 2015 ku premtohej Ri natyralizimi i Kodrës së Currilave në Durrës ku premtohej mbjellja e 50 mijë fidanëve? ", bëjmë me dije se ne janar te vitit 2016, fondi pyjor dhe kullosor kaloi ne administrim dhe pronësi te | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | së Currilave në Durrës ku premtohej mbjellja e 50 mijë fidanëve?<br><br>- A ka një plan për ta shndërruar këtë zonë në një shëtitore të lidhur me Kodrën e Vilës, siç ka qenë planifikuar | | Njësive te Vetëqeverisjes Vendore (NjVV), ne rastin konkret te Bashkisë Durrës. Si rrjedhoje, administrimi dhe vazhdimësia e projekteve mbi objektin Kodra e Currilave, nga janari 2016, është e drejte dhe kompetence e Bashkisë Durrës.<br><br>Ne lidhje me pyetjen e dyte se: "A ka një plan për ta shndërruar këtë zonë në një shëtitore të lidhur me Kodrën e Vilës, siç ka qenë planifikuar?" kjo pyetje ta adresoje për Bashkisë Durrës, pasi jo vetëm zona ne fjale është ne përgjegjësi administrimi te kësaj bashkie, por edhe për faktin qe çdo NjVV, tashme ka nja projekt te Planifikimit te Territorit nen administrimin e saj. | | |
| 12 | 21.02.2023 | 1.A ka donjë projekt Ministria e Turizmit në lidhje me fshatin Lavdar të Korçës që të kthehet në fshat turistik?<br><br>2.Nëse po , çfarë vlerë do të ketë ky projekt?<br><br>3.Nëse po, në çfarë faze është projekti?<br><br>4.Nëse jo , a është planifikuar që të ketë një projekt të tillë për fshatin Lavdar? | 03.03.2023 | Për fshatin Lavdar, referuar vendimit Nr. 21, datë 12.1.2018 për disa shtesa në vendimin nr. 709, datë 29.10.2014, Të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014– 2020”, ju bëjmë me dije se:<br><br>Fshati Lavdar, nuk përfshihet në listën e 100 fshatrave të programit të sipërcituar ose të ndonjë projekti aktual. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 5.A ndodhet fshati Lavdar në listën e projektit “100 fshatrat” ? | | | | |
| 13 | 20.02.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me relacionet e projektvendimeve si me poshtë:<br><br>1.Për miratimin e ndryshimit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” vresht në “tokë urbane” truall të sipërfaqes 390.99 m2, pjesë e pasurisë me numër 1/394, dhe të sipërfaqes 269.13 m2, pjesë e pasurisë me numër 2/465, zona kadastrale 1476, Bashkia Dropull<br><br>2. Për një ndryshim në vendimin nr. 298, datë 20.4.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e | 03.03.2023 | Përfunduar dërguar informacioni kërkuar. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Agjencisë Kombëtare të Turizmit"<br><br>3. Për dhënien e statusit të veçantë "Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special" aplikuesit "Green Coast" sh.p.k | | | | |
| 14 | 22.02.2023 | Kërkesë për informacion: 1. Sa është numri i "të sinjalizuarve" në organizatën tuaj, gjatë pesë viteve të fundit (2018;2019; 2020; 2021; 2022) dhe në secilin prej viteve të mësipërme?<br><br>2. Cila është struktura e njësisë përgjegjëse (numri i anëtarëve të | | 1. Sa është numri i "të sinjalizuarve" në organizatën tuaj, gjatë pesë viteve të fundit (2018;2019; 2020; 2021; 2022) dhe në secilin prej viteve të mësipërme.<br><br>Gjatë pesë viteve 2018 – 2022, në strukturën përgjegjëse për sinjalizimin nuk është regjistruar asnjë rast sinjalizimi për rrjedhojë nuk kemi patur të sinjalizuar.<br><br>2. Cila është struktura e njësisë përgjegjëse (numri i anëtarëve të kësaj strukture; formimi, statusi dhe niveli përfaqësues administrativ i anëtarëve të saj) që regjistron, shqyrton dhe inspekton procedurat e hetimit administrativ të nisura për shkak të sinjalizimeve të marra nga sinjalizuesit, si dhe hetimet për mbrojtjen e | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kësaj strukture; formimi, statusi dhe niveli përfaqësues administrativ i anëtarëve të saj) që regjistron, shqyrton dhe inspekton procedurat e hetimit administrativ të nisura për shkak të sinjalizimeve të marra nga sinjalizuesit, si dhe hetimet për mbrojtjen e sinjalizuesve, brenda autoritetit publik; mbi ç 'kritere është bërë përzgjedhja dhe funksionimi i njësive përgjegjëse?<br><br>3.Sa sinjalizime të brendshme janë regjistruar në organizatën tuaj, gjatë periudhës në fjalë?<br><br>4. A ka pasur rast kur anëtarët e njësisë përgjegjëse kanë deklaruar se kanë qënë në kushtet e konfliktit të interesit, përpara | | sinjalizuesve, brenda autoritetit publik; mbi ç 'kritere është bërë përzgjedhja dhe funksionimi i njësive përgjegjëse.<br><br>Në zbatim të pikës 2 të VKM nr.816, datë 16.11.2016 "Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", struktura përgjegjëse për sinjalizimin në MTM është Drejtoria e Auditimit të Brendshëm dhe përbëhet nga Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe një specialist i saj.<br><br>3.Sa sinjalizime të brendshme janë regjistruar në organizatën tuaj, gjatë periudhës në fjalë.<br><br>Për periudhën 2018 – 2022 nuk kemi patur raste sinjalizimi të brendshëm.<br><br>4. A ka pasur rast kur anëtarët e njësisë përgjegjëse kanë deklaruar se kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit, përpara fillimit të hetimit administrativ për shkak të një sinjalizimi? Nëse po, në ç 'rrethana ka ndodhur; si është proceduar më tej, pas deklarimit.<br><br>Nuk kemi patur raste sinjalizimi për rrjedhojë nuk kemi qenë në kushtet e konfliktit të interesit.<br><br>5. Kopje e plotë e rregullores lidhur me zhvillimin e procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | fillimit të hetimit administrativ për shkak të një sinjalizimi? Nëse po, në ç ‘rrethana ka ndodhur; si është proceduar më tej, pas deklarimit?<br><br>5. Kopje e plotë e rregullores lidhur me zhvillimin e procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit.<br><br>6. Sa është numri i hetimeve administrative të kryera pas marrjes së sinjalizimeve; numri inspektimeve të kryera nga njësia përgjegjëse në kuadrin e hetimeve administrative të filluara?<br><br>7. Sa prej hetimeve administrative të kryera në kuadrin e një sinjalizimeve kanë | | Bashkëlidhur Rregulloren e Brendshme “Për procedurën e shqyrtimit të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja”, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.<br><br>6.Sa është numri i hetimeve administrative të kryera pas marrjes së sinjalizimeve; numri inspektimeve të kryera nga njësia përgjegjëse në kuadrin e hetimeve administrative të filluara.<br><br>Nuk kemi patur sinjalizimi për rrjedhojë nuk kemi patur raste të hetimit administrative.<br><br>7. Sa prej hetimeve administrative të kryera në kuadrin e një sinjalizimeve kanë rezultuar në shkelje administrative.<br><br>Nuk kemi patur sinjalizimi për rrjedhojë nuk kemi patur raste të hetimit me shkelje administrative.<br><br>8. Sa është numri i sinjalizimeve të cilat nuk janë depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga legjislacioni (60/2016); ose nuk kanë pasur elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.<br><br>Nuk kemi patur raste sinjalizimi që nuk janë depozituar sipas formës dhe përmbajtjes ose që nuk kanë pasur elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.<br><br>9. Sa është numri i sinjalizimeve të bazuara, të cilat i keni referuar në prokurori apo në Policinë e Shtetit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rezultuar në shkelje administrative?<br><br>8. Sa është numri i sinjalizimeve të cilat nuk janë depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga legjislacioni (60/2016); ose nuk kanë pasur elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale?<br><br>9. Sa është numri i sinjalizimeve të bazuara, të cilat i keni referuar në prokurori apo në Policinë e Shtetit?<br><br>10. Sa është numri i kërkesave për mbrojtje nga ana e sinjalizuesve, të cilët pretendojnë se janë, apo kanë qënë, subjekt i një akti hakmarrjeje? A janë kryer hetime administrative ndaj këtyre pretendimeve?. | | Nuk kemi patur raste sinjalizimi të cilët I kemi referuar në prokurori apo në Policinë e Shtetit<br><br>10. Sa është numri i kërkesave për mbrojtje nga ana e sinjalizuesve, të cilët pretendojnë se janë, apo kanë qënë, subjekt i një akti hakmarrjeje? A janë kryer hetime administrative ndaj këtyre pretendimeve.<br><br>Nuk kemi patur raste kërkesash për mbrojtje nga ana e sinjalizuesve, të cilët pretendojnë se janë, apo kanë qënë, subjekt i një akti hakmarrjeje.<br><br>11. Kopje të raporteve vjetore të njësive përgjegjëse mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.<br><br>Raportet vjetore të veprimtarisë së Njësisë Përgjegjëse të Sinjalizimit të dërguara pranë ILDKPKI janë pa raste sinjalizimi. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 11. Kopje të raporteve vjetore të njësive përgjegjëse mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. | | | | |
| 15 | 22.02.2023 | Kërkesë për informacion: 1. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit B për vitin 2017.<br><br>2. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit B për vitin 2018.<br><br>3. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit B për vitin 2019.<br><br>4. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit B për vitin 2020.<br><br>5. Subjektet që kanë marrë licencën e | 7.03.2023 | Përfunduar dërguar informacioni i kërkuar. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mjedisit të tipit B për vitin 2021.<br><br>6. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit B për vitin 2022.<br><br>7. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit B për vitin 2023.<br><br>8. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2017.<br><br>9. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2018.<br><br>10. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2019.<br><br>11. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2020. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 12. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2021.<br><br>13. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2022.<br><br>14. Subjektet që kanë marrë licencën e mjedisit të tipit A për vitin 2023. | | | | |
| 16 | 24.02.2023 | Kërkese për informacion: Sa gjoba janë vendosur ndaj bizneseve që nuk kanë zbatuar ligjin për zëvendësimin e qeseve plastike? Sa gjoba janë vendosur në Tiranë dhe sanë rrethe?<br><br>2. Sa janë vlerat minimale dhe maksimale që janë vendosur për këto subjekte? | 03.03.2023 | 1. Sa gjoba janë vendosur ndaj bizneseve që nuk kanë zbatuar ligjin për zëvendësimin e qeseve plastike? Sa gjoba janë vendosur në Tiranë dhe sa në rrethe?<br><br>Përsa i përket pyetjes së parë Ju bëjmë me dije se Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë ka kryer inspektime në subjektet që kanë si aktivitet kryesor prodhimin e qeseve plastike mbajtëse me ose pa veshë sipas standardeve të përcaktuara në VKM-në Nr. 367, datë 30.5.2022“Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme” i ndryshuar, nga ku ka vendosur 3 masa administrative me gjobë me vlerë me nga 500.000 lekë. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. Sa është shuma e mbledhur nga këto masa administrative?<br><br>4. Çfarë lloje biznesesh janë gjobitur kryesisht? | | Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër ka kryer inspektime në subjektet që kanë si aktivitet kryesor prodhimin e qeseve plastike mbajtëse me ose pa veshë sipas standardeve të përcaktuara në VKM-në Nr. 367, datë 30.5.2022“Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme” i ndryshuar, nga ku është konstatuar se subjektet prodhojnë qese plastike sipas kërkesave ligjore.<br>Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër ka kryer inspektime në subjektet që kanë si aktivitet kryesor prodhimin e qeseve plastike mbajtëse me ose pa veshë sipas standardeve të përcaktuara në VKM-në Nr. 367, datë 30.5.2022“Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme” i ndryshuar, nga ku është konstatuar se subjektet prodhojnë qese plastike sipas kërkesave ligjore.<br><br>2. Sa janë vlerat minimale dhe maksimale që janë vendosur për këto subjekte?<br><br>Masat administrative me gjobë janë vendosur me vlerën 500.000 lekë.<br><br>3. Sa është shuma e mbledhur nga këto masa administrative? | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Aktualisht nuk janë depozituar të ardhura nga masat administrative për mos zbatim të ligjit për zëvendësimin e qeseve plastike sepse janë në proces ekzekutimi.<br><br>4.Cfarë llojë biznesesh janë gjobitur kryesisht?<br><br>Në zbatim të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr.10 448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, VKM-së, nr. 568, datë 17.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit"si dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatueshmëria e VKM-së Nr. 367, datë 30.5.2022 "Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme" i ndryshuar, Ju bëjmë me dije se, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit kanë detyrim të ushtrojnë kontrolle vetëm në subjektet që kanë si aktivitet kryesor prodhimin e qeseve plastike mbajtëse me ose pa veshë. Qëllimi i këtyre kontrolleve konsiston në respektimin e kërkesave ligjore për prodhimin e qeseve plastike mbajtëse sipas standardeve të përcaktuara në VKM-në Nr. 367, datë 30.5.2022. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 17 | 28.02.2023 | Në bazë të ligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar në 17 Mars 2022, në<br><br>Shqipëri ndalohet importi dhe përdorimi i qeseve plastike. Lidhur me këtë kërkoj informacion për<br><br>çështjet e mëposhtme;<br><br>A respektohet në masën e duhur ligji për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike, a shihet një<br><br>ndërgjegjësim nga ana e bizneseve dhe qytetarëve?<br><br>A ka nisma të tjera Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të ndaluar plastikën dhe në produkte të tjera si<br><br>shishet e ujit, qumështit etj. apo edhe ambalazhimin e | 03.03.2023 | ***<u>Pyetje:</u>***<br><br>1. ***Në bazë të ligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar në 17 Mars 2022, në Shqipëri ndalohet importi dhe përdorimi i qeseve plastike. Lidhur me këtë kërkoj informacion për çështjet e mëposhtme;***<br><br>***A respektohet në masën e duhur ligji për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike, a shihet një ndërgjegjësim nga ana e bizneseve dhe qytetarëve?***<br><br>***<u>Përgjigje:</u>***<br><br>Në kuadër të zbatimit të ligjit Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka miratuar Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 367, datë 30.5.2022 "Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme" i ndryshuar, e cila përcakton parametrat teknike të trashësisë së mureve të qeses plastike gjatësinë e gjerësinë e qeses plastike, si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij akti.<br><br>Në këtë kuadër dhe ndjekjen e këtij akti është ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr. 190, datë 15.11.2022 "Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimin të Task – Forcës për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | produkteve ushqimore dhe ushqimore? | | plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme”.<br><br>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit përpara hyrjes në fuqi të akteve të sipërcituar, ka ndërmarr një sërë aktivitetesh ndërgjegjësimi nga:<br><br>1. Subjektet e prodhimit, riciklimit dhe importimit;<br>2. Në shkolla 9 vjeçare, të mesme dhe në Universitete Publik/Privat;<br>3. Në Biznese dhe pika Tregtare;<br>4. Në bashkëpunim me projektin GIZ të Qeverisë Gjermane dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka zhvilluar takime në 61 Bashki etj..<br><br>Aktualisht po vijon inspektimi nga Task - Forca në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nga institucionet e përcaktuar në Urdhër, deri më datë 1 Tetor 2023 në të cilën do të hartohet raporti mbi problematikat dhe progresin e zbatimit të legjislacionit në fuqi.<br><br>***Pyetje:***<br><br>***2. A ka nisma të tjera Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të ndaluar plastikën dhe në produkte të tjera si shishet e ujit, qumështit etj. apo edhe ambalazhimin e produkteve ushqimore dhe ushqimore?***<br><br>***Përgjigje:*** | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Për sa i takon pyetjes së 2, të sipërcituar, ju sqarojmë që për produktet si shishet e ujit, qumështit etj. apo edhe ambalazhimin e produkteve ushqimore dhe ushqimore, nuk ka nisëm për ndalimin në vendin tonë. | | |

## Mars 2023

| **Nr. (1)** | **Data e regjistrimit të kërkesës (2)** | **Objekti (3)** | **Data e kthimit të përgjigjes (4)** | **Përgjigja(5)** | **Statusi i kërkesës (6)** | **Tarifa (7)** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 18. | 08.03.2023 | Kërkesë për informacion: A parashikon Kodi i Punës ndërprerje të marrëdhënieve të punës për shkak të shkeljes te rregullores së brendshme për dhënien e intervistës pa miratimin e eprorit dhe a ka Ministria e<br><br>Turizmit dhe Mjedisit një prononcim për këtë rast ? | 24.03.2023 | Në vijim të emali-t Tuaj, përmes së cilit kërkohet informacion dhe prononcim nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të z. *** ****, me detyrë Drejtor i Administratë së Zonave të Mbrojtura Fier, për shkak të shkeljes së Rregullores së Brendshme për dhënien e intervistës pa miratimin e eprorit, ju bëjmë me dije si vijon:<br><br>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me marrjen dijeni mbi rastin nga institucioni i saj i varësisë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, ka shqyrtuar procedurën e ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të z*** dhe ka vlerësuar se është e nevojshme të rishikohet edhe njëherë vendimmarrja e punëdhënësit, pasi ka nevojë për argumente dhe informacion më konkret, nëse ka patur raste të përsëritura të këtyre shkeljeve nga ana e punëdhënësit apo të vërtetohet nëse shkelja ka sjellë | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pasoja shumë të rënda në mbarëvajtjen e punës për marrjen e masës ekstreme “Lirim nga detyra”.<br><br>Në këtë kuadër, pas shqyrtimit edhe një herë të procedurës së ndjekur, fakteve dhe provave të ndjekura nga AKZM, ky institucion, në cilësinë e punëdhënësit, ka anuluar urdhrin për Lirim nga detyra të z. *** ****. | | |
| 19. | 13.03.2023 | Kërkesë për informacion: Vini në dispozicion: Listën e targave të automjeteve ekzistuese në pronësi të institucionit tuaj. | 24.03.2023 | Kthyer përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. | Përfunduar | 0 |
| 20 | 20.03.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me relacionet e projektvendimeve te miratuara: 1-Për përjashtimin nga ndalimi i gjuetisë, për qëllime shkencore pasvaksinale, të kafshëve të vaksinuara, në kuadër të projektit IPA 2020, “Kontrolli dhe çrrënjosja e sëmundjes së tërbimit-faza IV” | 31.03.2023 | Përfunduar kthyer përgjigje me e-mail informacioni i kërkuar. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2-Për një ndryshim në vendimin nr. 325, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm”<br><br>3-Për shpalljen e habitatit të tulipanit shqiptar “Monument natyror”<br><br>4-Për shpalljen e ekosistemit natyror të lumit Vjosa “Park Kombëtar”, kategoria II<br><br>5-Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 569, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", të ndryshuar | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 21. | 27.03.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: 1.Inforrnacion mbi hartat e Bashkive Korçë, Kolonjë, Maliq, Devoll dhe Pogradec të miratuara me VKM-në nr.433, datë 08.06.2016 "Për Transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive".<br><br>2. Informacion mbi hartat e Bashkive Korçë, Kolonjë, Maliq, Devoll dhe Pogradec të miratuara me VKM-në nr.398, datë13.05.2020, Për disa ndryshime ne vendimin Nr.433, datë 8.06.2016, të Këshillit | 3.04.2023 | Në vijim të kërkesë ju bëjmë me dije se në linket bashkëlidhur janë dy VKM-të e kërkuara, vkm ka bashkëlidhur dhe listën e inventarit si është dhe në titullin, për hartat ju duhet ti drejtoheni Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.<br><br>https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/05/13/398/9b7b8688-7e7f-4386-b1de-9828da6a2df7<br><br>https://qbz.gov.al/eli/vendim/2016/06/08/433/b9698007-699c-4810-9d3e-ffec67509c2b | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të Ministrave, Për Transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive. | | | | | |

# Prill 2023

| Nr. (1) | Data e regjistrimit të kërkesës (2) | Objekti (3) | Data e kthimit të përgjigjes (4) | Përgjigja(5) | Statusi i kërkesës (6) | Tarifa (7) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 22. | 4.04.2023 | Kërkesë për informacion: konkretisht hartat e Ekonomive Pyjore për VKM nr.433 dhe VKM nr.398.<br><br>Bazuar ne Udhëzimin nr.1, date 26.01.2016 "PER MBAJTJEN E KADASTRES SE FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR KOMBETAR", ju jeni Autoriteti qe mban dhe përditëson hartat dhe fondin pyjor/kullosor. Për me tepër ju jeni edhe institucioni qe ka çuar ne Këshillin e Ministrave këto dy VKM, që pa harta janë te paplota. | 07.04.2023 | Lidhur me kërkesën për hartat e ekonomive pyjore për VKM nr. 433/2016 dhe 398/2020 ju sqaroj sa me poshtë:<br><br>Në radhe të parë që nga titulli i VKM-ve përcaktohet se transferimi i fondit pyjor dhe kullosor publik në pronësi të bashkive është bere me liste inventari dhe jo me harta.<br><br>Së dyti, bazuar ne këto akte ligjore është kryer regjistrimi i fondit pyjor dhe kullosor publik ne pronësi te bashkive dhe informacioni për statusin juridik të një prone brenda këtij fondi, përshirë edhe kartelën e pasurisë apo fragmentin e hartës , ndodhet ne ASHK Vendore përkatëse. Behet aplikim dhe kërkohet informacion për një pronë të caktuar.<br><br>Se treti, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucion politikebërës dhe bazuar në Ligjin e Pyjeve 57/2020, janë strukturat e menaxhimit te pyjeve te bashkive ato qe bëjnë azhornimet kadastrale ( si pronare te fondit pyjor dhe kullosor publik) dhe procesi i azhornimit përfundon ne Agjencinë Kombëtare te Pyjeve. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 23. | 5.04.2023 | Kërkesë për informacion:<br>Kërkojmë nga ju të na jepet informacioni i kërkuar:<br><br>1. Sa investime strategjike ka në ministrinë tuaj?<br><br>2. Specifikoni tipologjinë e investimeve strategjike (në turizëm, mjedis)?<br><br>3. Kush janë investitorët strategjikë(emrat e kompanive, personit fizik)?<br><br>4. Në çfarë zonash janë këto investime strategjike?<br><br>5. Në çfarë viti e kanë marrë statusin e investitorit strategjikë? | 20.04.2023 | Kthyer përgjigje nga AIDA. | Përfunduar | 0 |
| 24. | 13.04.2023 | Kërkese e përsëritur ne lidhje vënien ne | 18.04.2023 | Në vijim të kërkesës tuaj, ju informoj si në e-mail-in e mëparshëm: | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dispozicion hartat për dy VKM nr.433 dhe 398. Ne zbatim te Udhëzimit Nr.1, date 26.01.2017 "Për mbajtjen e kadastrës se fondit pyjor dhe kullosor kombëtar" shprehet qarte se si dhe se ne çfarë format mbahet, përditësohet dhe administrohet kadastra e fondit pyjor/kullosor.<br><br>Po ashtu pika 9 thotë se "Kadastra e pyjeve dhe kullotave ne Bashki dhe Agjencitë Rajonale te Zonave te Mbrojtura, pajiset me harta te ekonomive pyjore/kullosore te gjeoreferuara nga Kadastra Kombëtare e Fondit Pyjor dhe Kullosor.<br><br>Ju lutemi te na vendosni ne dispozicion hartat për dy VKM nr.433 dhe 398, te kërkuara | | Lidhur me kërkesën për hartat e ekonomive pyjore për VKM nr. 433/2016 dhe 398/2020 ju sqaroj sa me poshtë:<br><br>Në radhe të pare që nga titulli i VKM-ve përcaktohet se transferimi i fondit pyjor dhe kullosor publik në pronësi të bashkive është bere me liste inventari dhe jo me harta.<br><br>Së dyti, bazuar ne këto akte ligjore është kryer regjistrimi i fondit pyjor dhe kullosor publik ne pronësi te bashkive dhe informacioni për statusin juridik te një prone brenda këtij fondi , përshirë edhe kartelën e pasurisë apo fragmentin e hartës , ndodhet ne ASHK Vendore përkatëse. Behet aplikim dhe kërkohet informacion për një prone te caktuar.<br><br>Se treti, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucion politikëbërës dhe bazuar në Ligjin e Pyjeve 57/2020, janë strukturat e menaxhimit te pyjeve te bashkive ato qe bëjnë azhornimet kadastrale ( si pronare te fondit pyjor dhe kullosor publik) dhe procesi i azhornimit përfundon ne Agjencinë Kombëtare te Pyjeve.<br><br>Kërkesa juaj është publikuar dhe në regjistrin e kërkesave në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në linkun më poshtë:<br><br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/Rregjistri-i-K%C3%ABrkesave-Janar-Prill-2023.pdf | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nëpërmjet kërkesës për informacion nr.5.Prot, te datës 27/03/2023. | | | | |
| 25. | 14.04.2023 | 1. Sa agroturizme rezultojnë në vend?<br><br>2. Na vendosni në dispozicion listën e agroturizmeve të certifikuara në 5 vitet e fundit;<br><br>- Specifikojini sipas secilit vit, ndarë në emër subjekti, adresë dhe të dhëna të tjera;<br><br>3. Na vendosni në dispozicion listën e agroturizmeve që disponojnë certifikatë paraprake në 5 vitet e fundit;<br><br>- Specifikojini sipas secilit vit, ndarë në emër subjekti, adresë dhe të dhëna të tjera. | 24.04.2023 | Informacioni i kërkuar nga ana juaj është publik dhe mund të aksesohet në faqen e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në linkun si me poshte:<br><br>**Certifikate Agroturizmi**<br><br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Lista-me-Subjektet-e-certifikuara-te-agroturizmit.pdf<br><br>**Certifikate Paraprake Agroturizmi**<br><br>https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Lista-e-subjekteve-me-Certifikaten-Paraprake-te-Agroturizmit.pdf | Përfunduar | 0 |
| 26. | 14.04.2023 | Kërkesë për informacionin mbi: programin "Blue Flag" | 26.04.2023 | Stacionet e plazhit ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të VKM–së nr. 171, datë 27.3.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | (Flamuri Blu) te prezantuar nga Banka Botërore dhe Kombet e Bashkuara ne 2008 për ta përfshire ne projektin e turizmit bregdetar.<br><br>1. Çfarë është bere ne këto 15 vite nga Ministria e Turizmit ne lidhje me ketë certifikim për plazhet ne Shqipëri?<br>2. A ka qene pjese e strategjive te Ministrisë se Turizmit duke qene se ky certifikim përmbush shume elemente jo vetëm te sigurisë dhe aksueshmerise ne plazhe, por gjithashtu edhe te ruajtjes dhe mirëmbajtjes se tyre?<br>3. Cila është arsyeja qe bregdeti shqiptar është i vetmi pothuajse ne te gjithë Evropën qe nuk ka asnjë plazh te certifikuar me "Blue Flag"? | | veprimtarisë së stacionit të plazhit"". Nëpërmjet kësaj rregulloreje përcaktohen kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacioneve të plazhit në të gjitha zonat bregdetare, si dhe në bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat janë identifikuar si zona të përshtatshme për plazhe, me qëllim ofrimin e kushteve të përshtatshme e të standardeve cilësore për pushuesit.<br>Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe struktura inspektuese monitorojnë veprimtarinë e stacionit të plazhit, mbi zbatueshmerinë e kushteve të sigurisë, pastërtisë, qetësisë etj, në përputhje me kontratat e lidhura me subjektet.<br>Në planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023 është parashikuar Zhvillimi i Programit të Turizmit Bregdetar e Detar dhe krijimi i produkteve të reja duke ngritur e sistemin e certifikimit "Blue Flag" në plazhe e marina duke e paraqitur këtë si një nga standardet ndërkombëtare të plazheve. Ky standard është menduar të futet si koncept dhe të zhvillohet në plazhe e territorit tonë.<br>Si masë e parë janë prezantuar pjesa më e madhe e kritereve "Blue flag" për marinat, në një kod etik për operatorët turistik që ushtrojnë lundrimin turistik, pjese e aktiviteteve të turizmit detar. Agjencia Kombëtare e Mjedisit kryen monitorimin e ujërave larës në pikat e përcaktuara përgjatë vijës bregdetare të cilat janë të publikuara ne Programin e Monitorimit.<br><br>Procesi i certifikimi të plazheve "blue flag" paraqitet shumë kompleks dhe kërkon bashkëveprimin e disa institucioneve njëkohësisht të tilla si sektori privat, njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizata qeveritare dhe jo qeveritare. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4. Cilat janë zona me problematike te plazheve ne Shqipëri dhe cilat janë masat qe janë marre nga ana e strukturave për te përmirësuar situatën? | | | | |
| 27. | 18.04.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: Projekti i Shërbimeve Mjedisore, bashkëfinancim i Bankës Botërore, Agjencisë Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA) dhe Fondit për Mjedis Global (GEF), ka financuar për bashkitë Has, Malësi e Madhe, Korçë, Maliq, Berat dhe Gramsh, planet e reja të menaxhimit. Bazuar në ligjin Nr. 119/2014 “PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT”, kërkojmë të na vendosen në | 24.04.2023 | Kërkesa ju është përcjell Bashkive: Has, Malësi e Madhe, Korçë, Maliq, Berat dhe Gramsh. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dispozicion kopjet e këtyre planeve në formatin elektronik që disponon institucioni juaj. | | | | |
| 28. | 28.04.2023 | Kërkesë për informacion: Në vitin 2016 Ministria e Mjedisit nëpërmjet Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve ka zhvilluar një tender për "Sistemin elektronik të monitorimit të pyjeve", thënë më qartë vendosje kamerash vrojtimi në pika kyçe ku dyshohej se kalonte lënda drusore kontrabandë dhe sallë monitorimi nga qendra.<br><br>1 - Sa ka qenë fondi i vënë në dispozicion për këtë sistem monitorimi?<br><br>2 - Sa ka qenë kostoja e një pike monitorimi, si kamera, panelet diellore për të | 16.05.2023 | Kthyer përgjigje me shkresë. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | furnizuar me energji të vazhdueshme kamerat, kulla në të cilën ato kanë qenë vendosur? Lutem që të shoqërohen me dokumentacion!<br><br>3 - Cilat kanë qenë rezultatet e këtij sistemi monitorimi, statistikat e bllokimeve të lëndës drusore nga monitorimi on-line?<br><br>4 - Çfarë është bërë me këtë sistem elektronik të monitorimit të pyjeve, ku janë aktualisht kamerat e vendosura në terren? | | | | |

## Maj 2023

| Nr. (1) | Data e regjistrimit të kërkesës (2) | Objekti (3) | Data e kthimit të përgjigjes (4) | Përgjigja(5) | Statusi i kërkesës (6) | Tarifa (7) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 29. | 10.05.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me:<br>1- Sa është numri i projekteve në fushën e turizmit për periudhën 2020-2023?<br>2.-Sa ka qenë vlera për secilin projekt dhe kush janë përfituesit e tyre? | 17.05.2023 | Kthyer përgjigje. | Përfunduar | 0 |
| 30. | 19.05.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: Sa masa administrative janë vendosur nga korriku deri me sot ndaj subjekteve qe tregtojnë qese | 30.05.2023 | 1-**Sa masa administrative janë vendosur nga Korriku deri me sot ndaj subjekteve që tregtojnë qese plastike një përdorimshe?**<br><br>AKM në bashkëpunim me ISHMT gjatë hyrjes në fuqi të VKM - së Nr. 367, datë 30.5.2022 "Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | plastike njëpërdorimshëm?<br><br>- Sa është sasia e qeseve te sekuestruara gjate kësaj periudhe?<br><br>- Sa kontrolle janë kryer ne total ne te gjithë vendin?<br><br>- Si do ta përkufizonit ecurinë e nismës pa qese plastike, thuajse një vit me pas?<br><br>- Cilat janë hapat e radhës, ne kuadër te kësaj nisme? | | plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-<br>biodegradueshme" i ndryshuar, ka vendosur 7 masa administrative.<br><br>**2- Sa është sasia e qeseve te sekuestruara gjate kësaj periudhe?**<br><br>Sasia e qeseve të sekuestruara deri në Prill 2023, nga institucionet ligj zbatuese është 111 Kg.<br><br>**3-Sa kontrolle janë kryer në total në të gjithë vendin?**<br><br>AKM së bashku me ISHMT kanë kryer 2539 inspektime.<br><br>**4-Si do ta përkufizonit ecurinë e nismës pa qese plastike, thuajse një vit me pas?**<br><br>Ecuria e këtij procesi deri më tani nga vitet e kaluara mund të quhet e suksesshme por kërkohet<br>edhe më shumë punë në të gjithë hallkat kryesish:<br>a. Ndërgjegjësimi i komunitetit nëpërmjet shkollave dhe mediat;<br>b. Bashkërendimi institucional me shoqërinë civile etj..<br><br>**5- Cilat janë hapat e radhës, në kuadër të kësaj nisme?**<br><br>Zvogëlimi dhe mos përdorimi i qeseve plastike, nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese. | | |
| 31. | 22.05.2023 | Kërkese për informacion ne lidhje | 1.06.2023 | Dërguar informacioni kërkuar. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | me relacionet e projektvendimeve si me poshtë:<br><br>1-Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore"”<br><br>2-Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 247, datë 30.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"” | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3-“Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e miratuar për vitin 2023, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”<br><br>4-“Për miratimin e procedurave për kryerjen e veprimtarive të shfrytëzimit në Fondin Pyjor Kombëtar nga individë apo subjekte të licencuara | | | | |
| 32. | 22.05.2023 | Informacion ne lidhje me: Ju lutem kërkojmë opinionin tuaj lidhur me ndertimin e Aeroportit të Vlorës dhe ndikimin që mund të ketë në ekosistemin e zonës. .....Por edhe në zhvillimin e turizmit.<br><br>Bashkimi Europian në raportet e fundit, | 25.05.2023 | Në vitet 2019-2021 në Shqipëri është kryer Vlerësimi i Sistemit të Zonave të Mbrojtura me një proces të gjerë konsultimi. Studimi shqyrton të gjitha sipërfaqet e zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe analizon të gjithë vlerën e biodiversitetit në secilën prej tyre. Të gjithë grupet e interesit janë takuar/informuar gjatë procesit të vlerësimit, të udhëhequr nga një grup i pavarur ekspertësh. Gjithashtu, ministritë e linjës dhe agjencitë shtetërore ishin pjesë e konsultimit. Falë këtij procesi, sipërfaqja totale e zonave të mbrojtura në Shqipëri është rritur nga 17,5% në 21,3% dhe do të vijojë të rritet në 30% të sipërfaqes brenda vitit 2030. Vlen për t’u përmendur edhe | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | konventa e Bernës, shumë organizata mjedisore ndërkombëtare dhe shqiptare kanë reaguar kundër ndërtimit të tij në një zonë që sipas ornitologëve është rrugë shtegtimi për shumë shpend. | | shpallja e lumit Vjosa me tre degëzimet e tij, si lumi i fundit i egër në Europë, me statusin Park Kombëtar.<br>Zona ku po zhvillohet aeroporti përputhet me gjurmën ekzistuese të ish-aeroportit ushtarak të ndërtuar në fillim të viteve ’20, dhe pikërisht për këtë arsye është parë si alternativa më e favorshme. Ky proces ka kaluar edhe në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i cili ka bërë një vlerësim të ndikimeve të pritshme mjedisore direkte dhe indirekte të zbatimit ose moszbatimit të projektit, në lidhje me gjendjen e mjedisit në territor. Fusha ajrore ekzistuese është e pozicionuar në afërsi me zonat ekzistuese urbane (fshatrat) dhe autostradën aktuale Levan-Vlorë, e rrethuar nga ish-fusha bujqësore. Pista e aeroportit dhe zona e projektuar për zhvillimin e projektit janë larg zonës së peizazhit të mbrojtur dhe jo domosdoshmërisht në itinerarin e fluturimit të pelikanit për në Lagunën e Nartës. Gjithsesi janë renditur një sërë masash mbrojtëse për t’u zbatuar gjatë ndërtimit të aeroportit dhe gjatë funksionimit të aeroportit, të përcaktuara qartë edhe në VNM-në përkatëse, ku veçojmë detyrimin e Planit të Menaxhimit Ekologjik i cili përfshin detyrimisht komponentët e monitorimit shkencor. Informojë se MTM raporton në mënyrë periodike në sekretariatin e Konventës së Bernës (ku përfshihen dhe raportimet për Aeroportin e Vlorës dhe të gjitha procedurat e ndërmarra).<br><br>Përsa i përket turizmit, Aeroporti i Vlorës pritet të rrisë aktivitetin turistik në jugun e Shqipërisë. Në pikëpamjen e konkurrencës në fushën e turizmit, kujtojmë se Vlora gjendet përballë dy qytetesh turistike me aeroporte në Itali (Brindisi dhe Bari), pranë tre aeroportesh në Greqi (Selaniku, Janina, Korfuzi), aeroportit të dytë të Maqedonisë së Veriut që gjendet në Ohër, si edhe Mali i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Zi me dy aeroporte (Podgorica dhe Tivari). Turizmi është prioritet strategjik për Shqipërinë, për zhvillimin e ekonomisë. Vetëm në vitin 2022 Shqipëria pati 7,5 milionë vizitorë të huaj (1,1 milionë më shumë se viti 2019, që konsiderohej më i suksesshmi). Për zhvillimin turistik dhe rritjen e numrit të turistëve elitarë, si një formë zhvillimi për turizmin e qëndrueshëm, është i nevojshëm krijimi i akseseve infrastrukturore siç është Aeroporti i Vlorës për gjithë bregdetin e jugut. Siç është përmendur, si rezultat i këtij investimi do të ketë ndikime direkte nga operimi i aeroportit, ndikime indirekte nga shtimi i marrëdhënieve B2B, dhe ndikim të induktuar si rezultat i rritjes së të ardhurave personale të shkaktuara nga efektet direkte dhe indirekte dhe rritja e turizmit. Vlerësohet se Aeroporti i Vlorës do të gjenerojë 1,500 vende pune gjatë ndërtimit dhe menaxhimit të tij, dhe mijëra vende të tjera pune indirekte gjatë aktivitetit të tij. Theksojmë se gjatë konsultimeve publike, banorët si një ndër grupet kryesore të interesit, e kanë mbështetur maksimalisht këtë projekt duke vlerësuar impaktin që do të ketë në zhvillimin ekonomik të zonës. | | |
| 33. | 24.05.2023 | Ankimim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare. | 26.05.2023 | Kthyer përgjigje zyrtare me shkresë. | Përfunduar | 0 |
| 34. | 29.05.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: A ka patur kërkesë nga subjekti “A*** K***” shpk, për heqje të fondit | 02.06.2023 | Shoqëria "A*** K***” shpk, **nuk ka bërë kërkesë për heqje nga fondi pyjor pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të sipërfaqes që preket nga ndërtimi i hidrocentralit Kuç.** | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pyjor të sipërfaqes që preket nga ndërtimi i hidrocentralit Kuç, në rrjedhën e sipërme të pellgut ujëmbledhës të lumit Shushicë?<br><br>· Nëse po, kopje të vendimmarrjes në lidhje me këtë kërkesë. | | | | |
| 35. | 29.05.2023 | Informacion mbi njësitë e biznesit agroturizëm në bashkinë Dibër | 30.05.2023 | Në vijim të emaili-it të ardhur nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, ju informojmë se kompetence e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është pika 6 e kërkesës tuaj, me poshtë gjeni link-un e publikuar ne faqen e Ministrisë me informacion në lidhje me agroturizmin:<br><br>Lista e subjekteve te pajisura me certifikatë agroturizmi: https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/LISTA-ME-SUBJEKTET-E-PAJISURA-ME-CERTIFIKAT%C3%8B-.pdf<br><br>Lista e subjekteve te pajisura me certifikatë paraprake agroturizmi: https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Lisat-e-subjekteve-me-Certifikate-Paraprake.pdf | Përfunduar | 0 |
| 36. | 29.05.2023 | Informacion në lidhje me këto pyetje: 1.Sa bashki derdhin ujërat e ndotura në lumin | 30.05.2023 | Deleguar te AKUM | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Vjosa? 2.Cilat bashki derdhin ujërat e ndotura në lumin Vjosa? 3.A ka një plan/strategji për të frenuar këtë fenomen? 4. Nëse po, çfarë është parashikuar të bëhet konkretisht nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për këtë problematikë? 5. Nëse ka një projekt-investim, ju lutem mund të na e vini në dispozicion dokumentin? | | | | |
| 37. | 31.05.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1-Sa turistë kanë ardhur deri më tani në Shqipëri?<br><br>2. Nga cilat vende kanë ardhur turistët në Shqipëri?<br><br>3. Sa pritet të vijnë në Shqipëri (bazuar në rezervimet e hoteleve, biletat e avionit, trageteve, etj) | 01.06.2023 | Në vijim të email-it tuaj ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:<br><br>1. Sa turistë kanë ardhur deri më tani në Shqipëri?<br><br>2. Nga cilat vende kanë ardhur turistët në Shqipëri?<br><br>Per dy pyetjet e para lutemi referohuni publikimit te fundit te Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ne linkun: https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/BULETINI-I-TURIZMIT-MARS-2023-1.pdf<br><br>3.Sa pritet të vijnë në Shqipëri (bazuar në rezervimet e hoteleve, biletat e avionit, trageteve, etj)? | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Deri tani rritja ka qenë në masën 50.7% për katër mujorin e parë krahasuar me katër mujorin e parë të 2022. | | |
| 38. | 31.05.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1. Cilat janë projektet e ardhshme për të përmirësuar infrastrukturën turistike në vend?<br><br>2. Cilat janë politikat dhe rregullore të ndërmarra për të siguruar që turizmi të jetë një sektor i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm për mjedisin?<br><br>3. Si është Ministria e Turizmit e përfshirë në promovimin e turizmit të brendshëm dhe përkrahjen e turistëve vendas?<br><br>4. Cili është raporti femër /meshkuj i turistëve që vinë në vendin tonë? | 9.06.2023 | . *Cilat janë projektet e ardhshme për të përmirësuar infrastrukturën turistike në vend?*<br>Aktualisht Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka projekte të miratuar për infrastrukturën turistike, por është në proces hartimi të Udhëzuesit për Standardizimin e Rrjetit të Shtigjeve dhe përdorimit të tyre"<br><br>*2.- Cilat janë politikat dhe rregullore të ndërmarra për të siguruar që turizmi të jetë një sektor i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm për mjedisin?*<br>Informacionin për politikat e ndërmarra që turizmi të jetë një sektor i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm dhe për mjedisin e gjeni në linkun: https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf<br><br>*3.-Si është Ministria e Turizmit e përfshirë në promovimin e turizmit të brendshëm dhe përkrahjen e turistëve vendas?*<br>Promovimi i turizmit të brendshëm realizohet nga Agjencisë Kombëtare e Turizmit, e cila:<br>-Zbaton politikat e marketingut në fushën e turizmit;<br>-Ofron informacion për vizitorët, udhëtarët dhe turistët, për shërbimet turistike që ofrohen;<br>-Promovon produktin dhe destinacionet turistike brenda e jashtë vendit; | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 5. Cili lloj turizmi është më i zhvilluar dhe i preferuar nga turistet? | | -Promovon investimet në zonat me prioritet zhvillimin e turizmit,<br>-Inicion dhe nxit projekte për turizmin, propozon dhe harton materialet me karakter promocional.<br>Më shumë informacion gjeni në linkun https://akt.gov.al/<br><br>*4.-Cili është raporti femer\|meshkuj i turistëve që vinë në vendin tonë?*<br>Referuar të dhënave të INSTAT per vitin 2021 48% e turistëve janë femra dhe 52% janë meshkuj.<br><br>*5.-Cili lloj turizmi është më i zhvilluar dhe i preferuar nga turistet?*<br>Bazuar në Buletinin Statistikor të Turizmit rezulton se Turizmi Natyror është më i preferuar nga turistët. Më shumë informacion gjeni në linkun: https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/BULETINI-I-TURIZMIT-MARS-2023-1.pdf | | |

**Qershor 2023**

| Nr. (1) | Data e regjistrimit të kërkesës (2) | Objekti (3) | Data e kthimit të përgjigjes (4) | Përgjigja(5) | Statusi i kërkesës (6) | Tarifa (7) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 39 | 01.06.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: Sa fonde ka shpenzuar qeveria shqiptare ne harkun kohor 2003-2023 për ruajtjen dhe zhvillimin e liqenit te Prespës se madhe?<br>Sa fonde ka përthithur Shqipëria përmes donatoreve për liqenin e Prespës, ju lutem te na vini ne dispozicion projektet konkrete (2003-2023)<br><br>A ka ndonjë plan zhvillimi konkret ministria e Mjedisit për liqenin e Prespës se Madhe, nëse po ju lutem te na e vini ne dispozicion. Nëse jo, cilat janë arsyet qe mungon një plan zhvillimor për zonën? | 15.06.2023 | Kthyer përgjigje nga AKZM me shkresë zyrtare. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 40 | 05.06.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: Lejet e miratuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për kompaninë “BIBA-AL” shpk me numër nipti “L99122001V”.<br><br>2. Lejet e miratuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për kompaninë “Rraja Ndërtim” shpk me numër nipti “M14126201N”.<br><br>3. Lejet e miratuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për kompaninë “ALEKSI CONSTRUCTION” shpk me numër nipti “M12101009F”. | 16.6.2023 | Kthyer përgjigje nga AKM. | Përfunduar | 0 |
| 41. | 06.06.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: 1.Lidhja e bujqësisë me turizmin, si po arrihet një | 15.06.2023 | 1.Lidhja e bujqësisë me turizmin, si po arrihet një bashkëpunim më i lartë në këtë sektor për të arritur një rritje më të lartë ekonomike? | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | bashkëpunim më i lartë në këtë sektor për të arritur një rritje më të lartë ekonomike?<br><br>2.Çfarë janë disa hapa që po nxisin më shumë prodhimin vendas te turistët ? | | -Ministria e Turizmit dhe Mjedisit po bashkëpunon dhe është në proces pune për të dakordësuar së bashku me partnerin GIZ Albania, për të linçuar së shpejti një program strategjik për përcaktimin e 4 fshatrave turistike, të cilët do të shërbejnë si modele implementimi pilot për vitet 2023- 2024.<br><br>-Lidhja midis sektorit të bujqësisë dhe turizmit, që sjell rrjedhimisht edhe një rritje të lartë ekonomike në vend, realizohet edhe nëpërmjet veprimtarisë së agroturizimit.<br><br>Bazuar në Vkm-në nr. 22, datë 12.1.2018 “Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij” kjo veprimtari ndërlidhëse ka këto karakteristika:<br><br>· Agroturizmi është veprimtaria pritëse, që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrikulturore, me qëllimin për të tërhequr vizitorë, shpeshherë duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtaritë bujqësore ose veprimtari të tjera ndihmëse, që zhvillohen në atë mjedis bujqësor.<br><br>· Agroturizmi mbështet zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të zonave rurale nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së traditave dhe promovimit të produkteve tipike të zonës.<br><br>· Synimi i kësaj veprimtarie është nxitja e modeleve alternative të zhvillimit të produkteve turistike, nxitja e prodhimit bujqësor/blegtoral, zhvillimi i zonave rurale si | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dhe krijimi i një tregu të ri për produktet bujqësore/blegtorale.<br><br>· Veprimtaria pritëse zhvillohet në fermat bujqësore/blegtorale, në të cilat ofrohen aktivite të lidhura me prodhimin bujqësor/blegtoral, por duke mos cenuar mjedisin. Përfshirja e vizitorëve në aktivitetet e lidhura me fermën duhet të jetë me qëllim argëtues, edukues apo veprimtari të tjera të lidhura me mjedisin përreth.<br><br>Certifikimi i veprimtarisë së agroturizmit realizohet nga Komision Vlerësues, i përbërë nga 5 anëtarë, 3 prej të cilëve janë përfaqësues të caktuar nga ministri përgjegjës për turizmin dhe 2 nga ministria përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural.<br><br>Bazuar në vendimmarrjen e komisionit, ministri përgjegjës për turizmin lëshon:<br><br>a) certifikatën paraprake “Për veprimtarinë pritëse të certifikuar si agroturizëm”. Kjo certifikatë lëshohet për të bërë të zbatueshëm legjislacionin në fuqi për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe ka vlefshmëri deri në 2 vjet nga dhënia e saj;<br><br>b) certifikatën “Subjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit”. Certifikata lëshohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rinovimi, bazuar në kërkesën e subjekti<br><br>Pas certifikimit si veprimtari “Agroturizëm”(paraprak ose certifikatë) subjektet mund ti drejtohen programit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | IPARD i cili ofron mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga fondet e BE-së (75%) dhe qeverisë shqiptare (25%). Për më shumë informacion rreth kësaj procedure referohuni linkut https://azhbr.gov.al/.<br><br>2. Çfarë janë disa hapa që po nxisin më shumë prodhimin vendas te turistët?<br><br>Promovimi dhe marketingu që realizohet nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Turizmit. Më shume informacion gjeni në linkun https://akt.gov.al/.<br><br>Gjithashtu dhe aktivitetet e realizuara nga fermat ose bujtina që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit duke i nxitur turistët për të marrë pjesë në veprimtaritë bujqësore ose veprimtari të tjera ndihmëse, që zhvillohen në atë mjedis bujqësor. | | |
| 42. | 12.06.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: Para disa ditësh, Presidenti i Rajonit të Puglias, Michele Emiliano ka deklaruar në shtypin italian se Qeveria Shqiptare i ka autorizuar për fillimin e projektit të transportit të ujit nga | 13.06.2023 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk disponon një aplikim të tillë. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gjirokastra në Itali në rajonin e Puglias.<br><br>Në këtë rast, nuk kemi asnjë njoftim nga Qeveria shqiptare, publikim zyrtar nga Qendra e Botimeve Zyrtare apo njoftim nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për këtë marrëveshje.<br><br>Në kuadër të transparencës publike, redaksia "F** N***" kërkon si informacion:<br><br>1. Kur është arritur marrëveshja midis palëve?<br><br>2. Cilat palë kanë qenë të përfshira? Ju sjellim në vëmendje se burimi "Syri i Kaltër" është zonë e mbrojtur dhe nuk mund të realizohet asnjë marrëveshje pa miratimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. Pse nuk ka asnjë njoftim zyrtar të publikuar për rastin në fjalë?<br><br>4. Ju lutem, na vendosni në dispozicion marrëveshjen e arritur midis palëve. | | | | |
| 43. | 15.06.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me:<br><br>· Për vitin 2023, a është kryer dizensektimi i plazheve ? Cilat ?<br><br>· A keni raporte për dezinsektimin e plazheve?<br><br>· A kryhet cdo vit kjo procedurë? Nqs jo, pse?<br><br>· Cilat janë masat që ju si institucion keni marrë këtë vit? | 15.06.2023 | Deleguar te Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | · Cilat janë planet që keni për këtë sezon turistik? | | | | |
| 44 | 15.06.2023 | Përsëritje e kërkesës nr 43. | 29.06.2023 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk është institucioni përgjegjës në lidhje me këtë proces. | Përfunduar | 0 |
| 45. | 15.06.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: Sa është numri i rojeve bregdetare në plazhet e Shqipërisë?<br><br>2. Sa është numri i kullave të vrojtimit në plazhet shqiptare?<br><br>3. Cilat janë plazhet e etiketuara si “të rrezikshme” (të panjohura) në vend?<br><br>4. Sa është numri i subjekteve(bizneseve) ndaj të cilave janë marr masa për mosrespektimin e hapësirave publike në hapësirat publike te plazheve në vend gjatë periudhave 2020-2021/ 2021-2022? | 27.06.2023 | Kthyer përgjigje nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | (vendosja e shezlongëve në bregdet, ndërtimi i bareve në hapësira publike? | | | | |
| **46** | 15.06.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: Në dijeni të institucionit tuaj a ka burime dhe monumente natyrore që rrezikohen nga aktiviteti që do të kryejë kompania ***në bllokune Dumresë? | 29.06.2023 | Bazuar në pranëvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku kërkon të zhvillohet aktiviteti "Shpim kërkimor me pusin "Dumrea Deep - 1", Blloku Dumre – në tokë", Elbasan, me zhvillues "***" dhe aplikues "***", me nr. Aplikimi AN010420230003, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura. | Përfunduar | 0 |
| 47 | 16.06.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1. A janë monitoruar dhe inspektuar operatoret ekonomik që menaxhojnë mbetjet spitalore nga institucionet përgjegjëse në 5 vitet e fundit? Nëse po çfarë ju ka rezultuar nga këto inspektime? Ju lutem na vini në dispozicion disa | 29.06.2023 | 1-Referuar pikës së parë ju bëjmë me dije se nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në zbatim të legjislacionit mjedisor në fuqi ,si dhe VKM-në, Nr. 568, datë 17.07.2019, "*Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit*" ka kryer inspektimet të programuara për zbatimin e kërkesave ligjore në subjektet të cilat janë të pajisur me leje dhe licenca për trajtimin e mbetjeve mjedisore si më poshtë vijon:<br><br>MEDI-TEL, Leje Tipi A, me objekt veprimtarie "Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi", janë kryer 3 inspektime nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit . | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | raporte inspektimesh që keni kryer.<br><br>2. Një nga rekomandimet që ju ka dhënë Kontrolli i Lartë i Shtetit në vitin 2018 ka të bëjë me destinacionin përfundimtar të hirit që përftohet nga incenerimi. Sot që flasim a e dimë se ku përfundon ky hi? A ka landfille të posaçme për të?<br><br>3. AKM sipas rekomandimit të KLSH-së duhet që të kërkojë analizimin e hirit që mbete nga incenerimi i mbetjeve dhe ta vendos në kushtet e lejes së mjedisit për të gjitha subjekte që aplikojnë për leje mjedisi dhe do të merren me asgjësimin e mbetjeve spitalore. Është | | PURA -MEDICAL, Leje Tipi A, me objekt veprimtarie ”Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi, incenerimi i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve, asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit ose landfillimit”, janë kryer 2 inspektime nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.<br><br>VALE RECYCLING, Leje Tipi A, me objekt veprimtarie ”Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi”, janë kryer 5 inspektime nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.<br><br>ECO RICIKLIM, Leje Tipi A, me objekt veprimtarie ”Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi, incenerimi i mbetjeve duke përfshire mbetjet e kafshëve. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme”, janë kryer 4 inspektime nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.<br><br>2-Bazuar në ligjin Nr.10431, datë 22.09.2021 “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*”, i ndryshuar, Vendimit Nr.798, datë 29.09.2010 për miratimin e Rregullores "*Për administrimin e mbetjeve spitalore"* si dhe vendimit të këshillit të ministrave me Nr.402, datë 30.06.2021 “*Për miratimin e katalogut të mbetjeve”*, kodet që marrin mbetjet spitalore pas trajtimit me incenerim dhe autoklavim, janë mbetjet me kod 19 “Mbetje nga impiantet e trajtimit të mbetjeve, nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura off-site (jo në vend) dhe nga përgatitja e ujit të pijshëm dhe ujit për përdorim industrial”, specifikisht 19 01 Mbetje nga iceneratorët ose piroliza e mbetjeve 19 03 Mbetje të stabilizuara të ngurtësuara | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | plotësuar ky rekomandim?<br><br>4. Sipas jush cilat janë disa nga problematiket që vijon të ketë në asgjësimin e mbetjeve spitalore sipas direktivave të BE-së? | | AKM ka licencuar subjekte të cilat grumbullojnë këto kode mbetjesh.<br><br>3-Në Republikën e Shqipërisë, ka operatorë të pajisur me leje mjedisi me aktivitet “Lendfilli i mbetjeve” që operojnë në fushën e menaxhimit të mbetjeve, sipas operacioneve, metodave dhe proceseve në varësi të llojit të tyre.<br><br>Të gjithë subjektet e pajisur me leje mjedisi, me veprimtari për asgjësimin e mbetjeve spitalore janë të detyruar dhe monitorohen për zbatimin e kushteve për menaxhimin e mbetjeve.<br><br>Mbetjet që gjenerohen nga aktiviteti, të cilat identifikohen nëpërmjet kodeve, asgjësohen apo trajtohen sipas mënyrave të përcaktuara në lejet e mjedisit që disponojnë dhe duke u bazuar në teknikat më të mira të disponueshme (TMD).<br><br>4-Referuar pikës së katërt mendojmë se për përmirësimin e situatës së trajtimit të mbetjeve spitalore dhe përafrimit me direktivat e bashkimit Europian duhet të përmirësohen<br><br>Strategjitë dhe Planet për menaxhimin e mbetjeve spitalore në nivel qendror dhe lokal.<br>Projekteve për asgjësimin e mbetjeve spitalore.<br>Hartimi i programeve për zvogëlimin e rrezikut nga mbetjet spitalore. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Rritja e kapaciteteve dhe investime të mjaftueshme në sektorin e trajtimit të mbetjeve spitalore. | | |
| 48. | 21.06.2023 | Kërkese për informacion ne lidhje me: Perse Ministria e Turizmit dhe Mjedisit lejon aktivitetin e guroreve brenda zonave te mbrojtura?<br><br>2 - Perse nuk janë marre masa për heqjen e lejeve mjedisore, për subjekte qe ushtrojnë aktivitet brenda zonave ne mbrojtura?<br><br>3 - A planifikoni te hartoni politika ne te ardhmen, qe parashikojnë zhvendosjen e këtyre aktiviteteve? | 05.07.2023 | Kthyer përgjigje. | Përfunduar | 0 |
| 49. | 26.06.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me:1)-Në cilat zona përshkon projekti TAP në Shqipëri? | 10.07.2023 | Në vijim të informacionit të kërkuar, ju informojmë se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në lidhje me zhvillimin e projektit TAP në bazë të fushës së saj të përgjegjësisë Nëpërmjet Agjencisë Kombëtare te Mjedisit ka shqyrtuar aplikime për VNM për projektin TAP për vendndodhje të caktuara, aplikimet kryhen në E-Albania dhe në mbështetje të: | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2)-A kalon ai në toka pjellore për bujqësi? Nëse po, Cilat janë pasojat në mjedis?<br><br>3)- Çfarë ka përfituar Shqipëria nga ky projekt? A ka marrë Shqipëria gaz pas implementimit të TAP?<br><br>4)-Si e përdor gazin Shqipëria dhe cilat janë interesat e saj?<br><br>5)-Cilat janë interesat e banorëve në zonat ku kalon TAP që janë mbrojtur nga Ministria e Mjedisit? | | •Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis";<br>•VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 686, datë: 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, përgjegjësive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", të ndryshuar;<br>•Urdhrit të Kryeministrit Nr. 153, datë: 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data: 01.01.2020"<br>Vendimet publikohen në site-n e AKM *www.akm.gov.al*<br><br>Gjithashtu Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet se nuk ka të dhëna për këtë projekt. | | |
| 50. | 26.06.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me relacionet e projekt vendimeve:-VKM nr.315, datë 24.5.23 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të | 10.07.2023 | Dërguar informacioni i kërkuar. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pasurive me nr.178/44, 152/43 dhe 182, në zonën kadastrale nr.1522”<br><br>-VKM nr.316, datë 24.5.23 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 22, datë 12.1.12018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij", të ndryshuar”<br><br>VKM nr.339, datë 31.5.23 “Për një shtesë në vendimin nr.1156, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe kritereve të përdorimit të tyre”” | | | | |

## Korrik 2023

| Nr. (1) | Data e regjistrimit të kërkesës (2) | Objekti (3) | Data e kthimit të përgjigjes (4) | Përgjigja(5) | Statusi i kërkesës (6) | Tarifa (7) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 51. | 10.07.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1. Sa është numri total i personave qe kane përfituar nga skemat e mbështetjes financiare nga ministria juaj për ngritjen e biznesit te tyre gjate periudhës janar- dhjetor 2022'! Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj'! 2. Sa është numri i te rinjve (15-29 vjeç) qe kane qe kane përfituar nga skemat e | **20.07.2023** | 1.Lidhur me sa kërkoni ju informojmë se përzgjedhja e projekteve behet në mbështetje te ligjit 93/2015 “Për turizmin”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.04.2016 “Për caktimin e kritereve e të afateve të kërkese propozimeve për mbështetje financiare në fushën e turizmit”.<br><br>2. Sqarojmë se, referuar pikës 2 të VKM të sipërpërmendur, ku citohet se “Ministria përgjegjëse për turizmin përzgjedh projektet në fushën e turizmit duke vlerësuar ndikimin social, mjedisor dhe ekonomik të tyre” si dhe pikës 5 ku thuhet se “ Projektet do te përzgjidhen, do te synojnë a) përgatitjen e studimeve apo te modeleve te produkteve turistike b) promovimin e studimeve turistike e te vlerave te trashëgimisë natyrore dhe kulturore te vendit c) zhvillojnë veprimtari | **Përfunduar** | **0** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mbështetjes financiare nga ministria juaj për ngritjen e biznesit te tyre gjate periudhës janar- dhjetor 2022'! Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? | | ne fushën e turizmit, me qellim rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e shërbimit, projektet nuk kanë për qellim ngritjen e biznesit por promovimin e turizmit.<br><br>3. Referuar pyetjes se sa është numri total i personave që janë shpallur fitues për vitin 2022 ju bëjmë me dije se janë shpallur 48 subjekte fituese.<br><br>• Përsa i përket gjinisë dhe moshës ju informojmë se administratoret janë 25 meshkuj dhe 23 femra, nga të cilët 1 është nën 29 vjeç | | |
| 52. | 17.07.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: A ka një bashkëpunim mes Ministrisë së Turizmit dhe autoriteteve vendore dhe operatorët e transportit<br><br>publik për të menaxhuar situatën e transportit gjatë sezonit turistik?<br><br>A ka në vend një plan veprimi për adresimin e transportit ndërqytetës gjatë sezonit turistik? | 18.07.2023 | Ne vijim te kërkesës tuaj, ju bej me dije si me poshtë vijon:<br><br>Me qellim zhvillimin e turizmit dhe promovimin e mëtejshëm të tij, në datë 02.12.2022 është nënshkruar **marrëveshja e bashkëpunimit** midis **Ministrisë se Turizmit dhe Mjedisit**, dhe **Drejtorisë se Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor** (në vijim DPSHTRR).<br><br>Në ketë marrëveshje është dakordësuar lancimi i platformës "eTransport", nëpërmjet së cilës realizohet digjitalizimi i transportit ndërqytetës dhe menaxhimi i fluksit të udhëtareve ne linjat e transportit ndërqytetës. Ndër të tjera, kjo marrëveshje ka si qëllim përmirësimin | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Cilat inovacione dhe teknologji të reja janë përdorur ose planifikohen të përdoren për të përmirësuar<br><br>transportin publik për turistët në Shqipëri gjatë sezonit turistik?<br><br>Çfarë plane investimesh ka Ministria e Turizmit për të përmirësuar infrastrukturën e transportit publik në<br><br>zonat turistike në Shqipëri? Cilat janë prioritetet e investimeve në këtë fushë? | | e eksperiencës së udhëtimit nëpërmjet standardizimit, sigurisë dhe aksesueshmerisë së udhëtareve dhe turisteve te huaj si dhe përcjelljen e statistikave të fluksit total të udhëtareve tek Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.<br><br>Në vijim do te gjeni dhe linkun e platformës e-transport: https://etransport.al/home<br><br>Sa më sipër, lutem të referoheni pranë Drejtorisë se Përgjithshme të Shërbimeve dhe Transportit Rrugor për trajtimin e çështjeve të shtruara ne kërkesën tuaj lidhur me transportin ndërqytetës dhe infrastrukturën përkatëse, duke qenë se DPSHTRR është institucioni kompetent, referuar termave te marrëveshjes se cituar më sipër. | | |
| 53 | 17.07.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: 1.Hapësirën e plazhit publik (me metra, bazuar ne ndarjen 100/30%) nga hotel primavera deri tek "Luani" (pranë fushave të<br>tenisit). | 24.07.2023 | Deleguar te Agjencia Kombëtare e Bregdetit | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2. Hapësirën e plazheve publike ne Zvërrnec,<br>3. Hartën digjitale ose atë qe disponon bashkia Vlore te plazheve publike ne raport (përqindje) me hapësirën e shfrytëzuar nga privati.<br>4. Hapësirën e plazhit publik ne Seman, Darzezë, Orikum, Radhime, Durrës (gjithë vija bregdetare), Shëngjin (gjithë vija bregdetare), Spille.<br>5. Numrin e rojeve bregdetare qe mbulojnë plazhet e sipërpërmendur.<br>6. informacion për çmimet e shezlloneve dhe çadrave (nëse disponon Ministria juaj, kanë çmime tavan apo mund ti vendosin pronaret e lokaleve sipas dëshirës, nenin ku përcaktohet kjo) në plazhet private | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 54. | 19.07.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: A ka nisur kompania ******” ** punën në bllokun e Dumresë në dijeni të institucionit tuaj? Në<br><br>çfarë date dhe në çfarë faze është puna?<br><br>-A ka dorëzuar kompania një VNM? Nëse po në çfarë date?<br><br>-Kopje të VNM që kompania *** ka dorëzuar.<br><br>-Në dijeni të institucionit tuaj a ka burime dhe monumente natyrore qe rrezikohen nga aktiviteti që do të<br><br>kryejë kompania *** në bllokun e Dumresë? Cilat janë këto monumente? Çfarë masash ka marrë | 31.07.2023 | Kthyer përgjigje nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | institucioni juaj në lidhje me këtë çështje?<br><br>-A ka kryer kompania në fjalë konsultim publik me banorët e fshatrave të cilat do të preken nga ky<br><br>aktivitet. Kur është kryer konsultimi ?Një kopje të raportit(dosje edhe dëgjesa me publikun, sipas legjislacioneve në fuqi) nëse institucioni juaj e disponon<br><br>-Çfarë licencash dhe lejesh zotëron kompania "*****" për ushtrimin e aktivitetit në fjalë? Kopje të listës nëse institucioni juaj e zotëron. | | | | |
| 55. | 20.07.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016 '*Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit* | 24.07.2023 | Udhëzimi nr.1/2016 për dhënien ne përdorim me kontrate qiraje është ne fuqi. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *dhe të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*', ju lutemi të na informoni nëse ky udhëzim është në fuqi dhe në qoftë se jo, ka ndonjë udhëzim apo akt tjetër që e zëvendëson atë. | | | | |
| 56. | 21.07.2023 | Kërkese për informacion ne lidhje me:<br><br>1. A ka një liste te lejuar te pesticideve dhe plehrave kimike dhe atyre qe janë te ndaluara për tu përdorur për qëllime bujqësore ne Zonat e Mbrojtura?<br><br>2. Cilat janë Zonat e Mbrojtura në shkallë vendi që kërcënohen nga përdorimi tej normës i PMB të lejuara dhe PMB të ndaluara?<br><br>3. A kërcënohen liqenet e Prespës dhe Ohrit në afërsi të cilave ka aktivitet të dendur | 21.07.2023 | Deleguar Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | bujqësor nga përdorimi i PMB?<br><br>4. Në kushtet kur ligji për Zonat e Mbrojtura ndalon përdorimin e PMB sa zbatohet kuadri ligjor në<br><br>kushtet kur fermerët që jetojnë në afërsi të këtyre zonave i kultivojnë tokat e tyre bujqësore?<br><br>5. Në rastet kur përdorimi i PMB-ve në Zonat e Mbrojtura sipas ligjit kërkon leje të posaçme, sa është numri i lejeve të dhëna për Zonat e mbrojtura të liqeneve të Ohrit dhe Prespës?<br><br>6. Çfarë impakti ka për mjedisin përdorimi i PMB-ve?<br><br>7. A keni të dhëna të pasojave të shkaktuara nga përdorimi i PMB-ve në ekosistemin e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | liqeneve të Ohrit dhe Prespës? | | | | |
| 57. | 24.07.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: Në 18 maj të vitit 2020 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural hapi thirrjen për tenderin me fond limit 29,400,000 lekë pa TVSH për “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae)” me procedurë të kufizuar.<br><br>Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës publike u ngarkua dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.<br><br>Ne kemi verifikuar se në Shqipëri nuk ka asnjë kompani të licencuar në mbrojtjen biologjike të pyjeve. | 25.07.2023 | Referuar Vendimit nr.373, datë 6.5.2020 “Për caktimin e ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural si autoritet kontraktor për realizimin e procedurës së prokurimit, me objekt “mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza galeformuese dryocosmus kuriphilus hymenoptera cynipidae”, pika3 citon:<br><br>1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, monitoron respektimin e kërkesave teknike trajtuese të vendosura në zbatim të këtij procesi.<br><br>Ndërkohe është MBZHR autoritet kontraktor për realizimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae)”, dhe po kjo Ministri është e ngarkuar për lidhjen e kontratës objekt prokurimi dhe monitorimin e zbatimit të kontratës. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ekspertët vendas në mbrojtjen biologjike të pyjeve dhe raportet shkencore që merren si referencë nga vendi fqinj, Italia, shpjegojnë se duhen bërë njëherë vlerësimet dhe studimet e mjedisit përpara dërgimit të insektit (Torymus Sinensis Kamijo) nga laboratori biologjik që lufton grerëzën kineze.<br><br>Duke marrë shkas nga këto të dhëna, ne ju lutemi për koment:<br><br>1. a) Si e ka realizuar kompania (GJERGJI-IMPEX) shpërndarjen e insektit (Torymus Sinensis Kamijo) kur nuk ka patur asnjë eksperiencë në këtë fushë?<br><br>b) Cili ka qënë eksperti në mbrojtjen e bimëve që ka asistuar të gjithë | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | procesin për llogari të kompanisë private?<br><br>2. a) Nga cili laborator europian është importuar insekti (Torymus Sinensis Kamijo)?<br><br>b) A i keni verifikuar këto dokumente që provojnë se në zonën e Shkodrës është shpërndarë ky insekt (Torymus Sinensis Kamijo) në vitin 2020? | | | | |
| 58. | 24.07.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: Në lidhje me zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkëpunim në fushën e Turizmit në Ballkanin Perëndimor.<br><br>Ju lutem vendosni ne dispozicion të informacioneve si më poshtë vijon: | 04.08.2023 | Ne baze te ligjit 43/2016. Alternatet origjinale, printimi i tyre bazuar, i ndjek procedurat Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) dhe arkivohen ne MEPJ kopjet origjinale, për çdo dokumentacion qe ju kërkoni ju lutem drejtohuni MEPJ.<br>Ndërsa për aktivitet e zhvilluara ne kuadër te memorandumit është Agjencia Kombëtare e Turizmit qe ndjek organizimet e tyre. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | -Kopje të memorandumit ne gjuhën shqipe,<br><br>-Datën e ratifikimit nga Qeveria e Shqipërisë dhe numrin e aktit (nëse ka);<br><br>-Listë të autoriteteve(Institucioneve) të përfshira në zbatimin t kësaj marrëveshjeje<br><br>- Dokumentin/aktin për krijimin e Grupit i Përbashkët te Punës për bashkëpunim ne fushën e turizmit sipas nenit 5 te "Memorandumit te Mirëkuptimit për Bashkëpunimin e Fushën e Turizmit ne Ballkanin Perëndimor".<br><br>-Listën e pjesëmarrësve ne grupin e punës përfshire informacione si punonjësi përfaqësues, emër mbiemër dhe pozicionin | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | e punës ne institucionin qe përfaqëson, vendin;<br><br>-Raportet e monitorimit te zbatimit te "Memorandumit te Mirëkuptimit për Bashkëpunimin ne Fushën e Turizmit ne Ballkanin Perëndimor" qe nga hyrja ne fuqi e deri mes  t, te prodhuara nga Grupit i Përbashkët te Punës ose organe te tjera.<br><br>-Akte/dokumente, përfshire listën e marrëveshjeve dyvjeçare te aktiviteteve te  përbashkëta, te<br><br>miratuara nga Grupit i Përbashkët te Punës për turizmin.<br><br>-Përfundimet e të gjitha takimeve te Grupit te Përbashkët te Punës te mbajtura nga themelimi deri me sot. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | -A disponon institucioni hapësirën fizike dhe infrastrukturën teknike për te mundësuar zbatimin e kësaj marrëveshje (zyra, poste pune, pajisje teknike dhe teknologjike)?<br><br>-A disponon institucioni stafin e nevojshëm për zbatimin e kësaj marrëveshje?<br><br>-Çdo informacion tjetër apo angazhim te punonjësve te institucionit ne kuadër te Nismës Ballkani i Hapur. | | | | |

## Gusht 2023

| Nr. (1) | Data e regjistrimit të kërkesës (2) | Objekti (3) | Data e kthimit të përgjigjes (4) | Përgjigja(5) | Statusi i kërkesës (6) | Tarifa (7) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 59. | 01.08.2023 | Kërkese për informacion ne lidhje me: 1.Lidhja e kulturës me turizmin, si po arrihet një bashkëpunim më i lartë në këtë sektor për të arritur një rritje më të lartë ekonomike? Ju lutem përmendni hapat konkret që po ndërmerrni në këtë drejtim.<br><br>2.Nxitja e prodhimit vendas: Çfarë hapa po ndërmerrni për të inkurajuar më shumë turistë të blejnë produkte | 10.08.2023 | 1.Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në kuadër të mbështetjes financiare për projektet në fushën e turizmit një vend të rëndësishëm zë turizmi kulturorë. Përgjatë vitit 2023 në totalin e 34 projekteve fituese që përfitojnë mbështetje financiare nga Ministria e Turizmit, 13 projekte janë me tematikë dedikuar zhvillimit të destinacioneve kulturore në nivel kombëtar.<br><br>Projekt i rëndësishëm për eventet e turizmit kulturorë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit, publikimi i Kalendarit Turistik Kombëtar 2023, me mbi 1100 aktivitete të ndryshme nëpërmjet aplikacionit "TEA".<br><br>Gjatë viteve të fundit një numër i konsiderueshëm destinacionesh turistike kulturore janë promovuar dhe vizituar. Institucione e kulturës raportojnë se në muajin e tretë të vitit 2023 numri i vizitorëve të huaj dhe vendas që kanë vizituar institucionet e kulturës, është rritur 32% më shumë se numri i vizitorëve në mars 2022.<br><br>2.Në pikat kufitare dhe konkretisht në Portin Turistik të Durrësit në momentin e kontrollit të dokumentacionit pjesës më të madhe të turistëve vendas dhe të huaj u shpërndahet nga punonjësit e policisë disa broshura ku promovohen prodhimet artizanale të zonave të ndryshme. Gjithashtu dhe në projekte e përmendura dhe më lartë vend të rëndësishëm kanë zënë dhe projektet që në fokus | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | vendase, si punime artizanale etj ? | | të tyre kanë pasur promovimin e produkteve artizanale tradicionale. Në vijim të projektit të qeverisë Rilindja Urbane ku shumë zona të vjetra karakteristike të qyteteve tona të lëna në harresë të cilat kanë lulëzuar në aspektin e infrastrukturës. Ministria Turizmit dhe Mjedisit duke pasur në këto zona tashmë një infrastrukturë të përmirësuar, shumë aktivitete turistike i ka zhvendosur dhe zhvilluar në këto zona. Duke sjellë në këtë mënyrë vëmendjen e turistëve vendas dhe të huaj dhe rritur numrin e tyre në to. Kjo ka sjellë dhe rihapjen dhe zhvillimin e shumë dyqaneve ku tregtohen dhe promovohen produktet artizanale (psh pedonalja e Shkodrës, lagjja e vjetër Muradie në Vlorë, lagjet e Gjirostrës, Korça etj) | | |
| 60. | 02.08.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1 a. Listën e subjekteve të licencuara në fushën e agroturizmit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2015.<br>b. Sipërfaqet e shfrytëzimit nga këto subjekte për zonat pyjore nëse ka.<br>c.Harta e projektit me njollën e mbivendosur në | 15.08.2023 | 1.Listën e subjekteve të licencuara në fushën e agroturizmit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit?<br>Për sa I përket te pajisura me certifikatë agroturizmi I gjeni ne link-un më poshtë te cilat janë publikuar ne faqen e MTM: https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/LISTA-ME-SUBJEKTET-E-PAJISURA-ME-CERTIFIKAT%C3%8B-.pdf<br><br>2. Sipërfaqet e shfrytëzimit nga këto subjekte për zonat pyjore nëse ka?<br>Subjektet e pajisura me certifikatë nuk kane në zotërim apo marrje ne përdorim të sipërfaqeve pyjore.<br><br>3. Harta e projektit me njollën e mbivendosur në njësinë administrative.<br>Për sa I përket projektit me njollën e mbivendosur ju duhet ti drejtoheni Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, ose vet subjekteve. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | njësinë administrative.<br><br>2.a) Listën e subjekteve të licencuara në fushën e agroturizmit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2016.<br>b) Sipërfaqet e shfrytëzimit nga këto subjekte për zonat pyjore nëse ka.<br>c) Harta e projektit me njollën e mbivendosur në njësinë administrative.<br><br>3.a) Listën e subjekteve të licencuara në fushën e agroturizmit nga Ministria e Turizmit dhe | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mjedisit për vitin 2017.<br>b) Sipërfaqet e shfrytëzimit nga këto subjekte për zonat pyjore nëse ka.<br>c) Harta e projektit me njollën e mbivendosur në njësinë administrative.<br><br>4.a) Listën e subjekteve të licencuara në fushën e agroturizmit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2018.<br>b) Sipërfaqet e shfrytëzimit nga këto subjekte për zonat pyjore nëse ka.<br>c) Harta e projektit me njollën e mbivendosur në | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | njësinë administrative.<br><br>5.a) Listën e subjekteve të licencuara në fushën e agroturizmit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2019.<br>b) Sipërfaqet e shfrytëzimit nga këto subjekte për zonat pyjore nëse ka.<br>c) Harta e projektit me njollën e mbivendosur në njësinë administrative.<br><br>6.a) Listën e subjekteve të licencuara në fushën e agroturizmit nga Ministria e Turizmit dhe | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mjedisit për vitin 2021.<br>b) Sipërfaqet e shfrytëzimit nga këto subjekte për zonat pyjore nëse ka.<br>c) Harta e projektit me njollën e mbivendosur në njësinë administrative.<br><br>7.a) Listën e subjekteve të licencuara në fushën e agroturizmit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2022.<br>b) Sipërfaqet e shfrytëzimit nga këto subjekte për zonat pyjore nëse ka.<br>c) Harta e projektit me njollën e mbivendosur në | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | njësinë administrative.<br><br>8.a) Listën e subjekteve të licencuara në fushën e agroturizmit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2023.<br>b) Sipërfaqet e shfrytëzimit nga këto subjekte për zonat pyjore nëse ka.<br>c) Harta e projektit me njollën e mbivendosur në njësinë administrative. | | | | |
| 61. | 02.08.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me:<br><br>1.Listën e subjekteve të pajisura me licencë | 08.08.2023 | Kthyer përgjigje nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në djegien e mbetjeve të rrezikshme në vitin 2015 dhe afatet e licencës të autorizuara nga Ministria.<br><br>2.Listën e subjekteve të pajisura me licencë në djegien e mbetjeve të rrezikshme në vitin 2016 dhe afatet e licencës të autorizuara nga Ministria.<br><br>3.Listën e subjekteve të pajisura me licencë në djegien e mbetjeve të rrezikshme në vitin 2017 dhe afatet e licencës të autorizuara nga Ministria. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4.Listën e subjekteve të pajisura me licencë në djegien e mbetjeve të rrezikshme në vitin 2018 dhe afatet e licencës të autorizuara nga Ministria.<br><br>5.Listën e subjekteve të pajisura me licencë në djegien e mbetjeve të rrezikshme në vitin 2019 dhe afatet e licencës të autorizuara nga Ministria.<br><br>6.Listën e subjekteve të pajisura me licencë në djegien e mbetjeve të rrezikshme në vitin 2020 dhe afatet e licencës të | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | autorizuara nga Ministria.<br><br>7.Listën e subjekteve të pajisura me licencë në djegien e mbetjeve të rrezikshme në vitin 2021 dhe afatet e licencës të autorizuara nga Ministria.<br><br>8.Listën e subjekteve të pajisura me licencë në djegien e mbetjeve të rrezikshme në vitin 2022 dhe afatet e licencës të autorizuara nga Ministria.<br><br>9.Listën e subjekteve të pajisura me licencë në djegien e mbetjeve të | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rrezikshme në vitin 2023 dhe afatet e licencës të autorizuara nga Ministria. | | | | |
| 62. | 02.08.2023 | Kërkese për informacion ne lidhje: 1.“Për disa ndryshime në vendimin nr. 417, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit"” 463 26.7.23<br><br>2.“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 419, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për | 15.08.2023 | Përfunduar dërguar informacioni i kërkuar. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", të ndryshuar” 315 24.5.23<br><br>3.“Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të pasurive me nr.178/44, 152/43 dhe 182, në zonën kadastrale nr.1522” 316 24.5.23<br><br>4.“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 22, datë 12.1.12018, të | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij", të ndryshuar" 339 31.5.23<br><br>5."Për një shtesë në vendimin nr.1156, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre"" | | | | |
| 63. | 04.08.2023 | Kërkese për informacion ne lidhje me: Sa | 04.08.2023 | Deleguar te Agjencia Kombëtare e Bregdetit. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përqind e plazheve të vendit janë publike?<br><br>Ju lutem na vini në dispozicion listën me vendndodhjen e këtyre plazheve sipas bashkive. | | | | |
| 64 | 09.08.2023 | Kërkesë për informacion: A shihet turizmi si një sektor që garanton zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri?<br>-A shihet Shqipëria si një vend me tregues të fortë për një industri të madhe turistike dhe a i përmbush të gjitha kushtet që i nevojiten një turisti?<br>-Cilët janë turistët që e vizitojnë më shumë Shqipërinë? | 24.08.2023 | 1.Vit pas viti, turizmi po kristalizohet gjithnjë e më shumë si një ndër motorët më kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit. Referuar Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm te Turizmit 2019 – 2023: “….*turizmi po hyn në kryefjalën e zhvillimit ekonomik, social dhe kombëtar të vendit tonë. Të dhënat vit pas viti dëshmojnë ngjitjen e turizmit si një ndër sektorët që sjellin më shumë të ardhura në buxhetin e shtetit, buxhetin sipërmarrës dhe atë familjar, me një kontribut direkt në PBB prej 8,5% dhe një vlerë të shtuar indirekte prej 26,2%. Turizmi është po ashtu edhe sektori që ka potencialin më të lartë të punësimit, nga ku 93 mijë kanë qenë të punësuarit direkt dhe mbi 291 mijë ishin të punësuarit total në këtë sektor përgjatë 2017-ës. Kjo do të thotë se vlera e shtuar e këtij sektori ka një rëndësi ekonomike dhe strategjike për vendin, pasi për çdo 1 lek të investuar, krijohen 3 lekë vlerë e shtuar dhe për çdo 1 të punësuar në këtë sektor, hapen 3 vende të reja pune*….”.<br><br>Perceptimi i sektorit të turizmit si një nga motorët kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit mbështetet gjithashtu nga të dhënat e fundit zyrtare të publikuara nga Instituti Shqiptar i Statistikave sipas te cilave, numri i shtetasve të huaj të hyrë në | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | -Sa brenda pritshmërive ishte ky vit turistik krahasuar me vitet e tjera? | | Shqipëri gjatë vitit 2022 është 7.543.817, duke u rritur me 32,6 %, në krahasim me vitin 2021.<br>Sipas publikimit të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit 2022, gjatë vitit 2021, sektori i turizmit regjistroi një kontribut total prej 3,092.7 milionë dollarë, duke zënë rreth 17.4% të PBB-së. Krahasuar me dy vitet e mëparshme ka një ndryshim +81,1% nga viti 2020 dhe -10% nga viti 2019. Përsa i përket punësimit, kontributi total i udhëtimeve dhe turizmit për vitin 2021 ishte 226,100 vende pune ose 20% e punësimit total në Shqipëri me një ndryshim +26.6% krahasuar me të dhënat e vitit 2020. Gjithashtu, shifrat për shpenzimet e vizitorëve për vitin 2021 u regjistruan në 2457,2 milionë dollarë për turistët ndërkombëtarë dhe 597,4 milionë dollarë për ata vendas me një rritje përkatësisht +83,5% dhe +60,9% krahasuar me vitin 2020.<br><br>Ndërkohë për 10 vjeçarin e ardhëm parashikohet një rritje e konsiderueshme e kontributit të këtij sektori në ekonomi, ku vetëm në 2-3 vite sektori i turizmit pritet të zërë 8,8% të PBB ndërkohë që deri në 2028, sektori mund të zërë deri në 9.3 % të PBB. Kësisoj, duke marrë në konsideratë këtë trend rritës, parashikohet që deri në 2028 efekti direkt dhe indirekt i sektorit të turizmit t`i afrohet rreth 1/3 të të gjithë Produktit të Brendshëm Bruto të Shqipërisë.<br><br>2. Sfidat kryesore të industrisë së turizmit për periudhën afatmesme te identifikuara ne strategjinë kombëtare te turizmit janë si më poshtë:<br>- Mundësimi i aksesit në destinacionet turistike, përmirësimi i infrastrukturës në destinacion dhe nxitja e zhvillimit të infrastrukturës turistike – Infrastruktura mbetet një nga elementët kyç si themeli pa të cilin industria e turizmit nuk mund të ketë as zhvillime sasiore e as cilësore. Për periudhën afatmesme, sfidë janë lidhjet e Shqipërisë me vendet e tjera, ku nevojitet shtimi i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | porteve e aeroporteve si edhe shpeshtimi i udhëtimeve lidhëse. Sistemi i brendshëm i transportit publik dhe aksesi në destinacionet turistike është një tjetër pikë që kërkon vëmendje. Po kaq me rëndësi është edhe infrastruktura në destinacion, e cila përfshin rrjetet elektrike e të kanalizimeve, mundësinë e parkimit etj. Së fundi, por jo për nga rëndësia, është incentivimi i infrastrukturës turistike, që nga marinat, komplekset e sporteve ujore e dimërore, golfit, qendrat e turizmit të aventurës, etj.<br>- Rregullimi, standardizimi dhe certifikimi i strukturave akomoduese dhe shërbimeve të tjera turistike – Zbatimi i një sistemi standardizimi dhe klasifikimi të strukturave akomoduese është një element i rëndësishëm që do të garantojë nivelin e cilësisë së operatorëve dhe shërbimeve të ofruara prej tyre, si dhe do të sigurojë rregullimin e tregut të turizmit duke nxitur tërheqjen e markave ndërkombëtare të hotelerisë e operatorëve turistikë. Nisur nga zhvillimi kaotik i deritanishëm, kjo është një sfidë për të ardhmen afatmesme.<br>- Promovimi i një produkti të integruar turistik dhe përmirësimi i imazhit të vendit – Sfida e tretë është kombinimi i atraksioneve dhe aktiviteteve turistike në produkte turistike të konsoliduara dhe promovimi i tyre në tregun rajonal, europian e global. Ngushtësisht i lidhur me këtë element, është edhe promovimi i vendit si një destinacion turistik i sigurt e mikpritës, me një ofertë turistike të konsoliduar e me produkte autentike.<br>- Ngritja e një sistemi efiçient të formimit të vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore të angazhuara në turizëm – Rritja e pritshme e numrit të turistëve do të ushtrojë një presion gjithnjë e në rritje mbi burimet njerëzore dhe sidomos mbi cilësinë e shërbimeve. Përballimi i masivizimit të turizmit do të jetë një sfidë e për këtë do duhet të ngrihet një sistem efiçient i formimit profesional i cili do të mundësojë trajnime të vazhdueshme për punonjësit e strukturave akomoduese e restoranteve, për udhërrëfyesit turistikë e kështu me rradhë për të gjithë ofruesit e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | tjerë të shërbimeve, duke mundësuar përmirësimin e cilësisë së tyre.<br><br>3. Gjatë vitit 2022, nga vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Spanja ka pasur rritjen më të madhe me 3,6 herë dhe Anglia me 85,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Më poshtë gjeni te dhënat e vizitorëve të huaj nga shtetet me numër më të madh të vizitorëve për periudhën janar-dhjetor 2022:<br><br>KOSOVË 2,639,462<br>MAQEDONI 678,412<br>GREQI 484,167<br>ITALI 610,578<br>ANGLI 166,599<br>MALI I ZI 441,625<br>POLONI 168,022<br>SHBA 138,079<br>SPANJË 45,235<br>GJERMANI 187,664<br>ZVICËR 65,159<br>FRANCA 79,116<br>AUSTRI 37,720<br>TURQI 94,912<br>BULLGARI 40,220<br>KROACI 31,099<br>RUMANI 41,456<br>SLLOVENI 17,120<br>SERBI 99,700<br>HOLLANDE 55,587<br>SUEDI 41,196<br>UKRAINË 38,847<br>BOSNJE&HER. 35,951 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 4. Vendimi i Këshillit te Ministrave nr. 171, date 27.03.2019, I ndryshuar, përcakton se afati i sezonit turistik do të jetë nga data 1 maj deri më 15 nëntor.<br><br>Gjithsesi, referuar te dhënave paraprake sa i takon flukseve te turisteve te huaj, por jo vetëm, qe kane preferuar ti kalojnë pushimet ne vendin tone, sezoni turistik 2023 premton te jete i mbare. Vetëm ne muajin korrik 1.7 milionë vizitorë të huaj kanë hyrë në Shqipëri, ose 26% më shumë, krahasuar me një vit më parë. Për periudhën janar-korrik 2023, mbi 5,1 milionë vizitorë të huaj kanë hyrë në Shqipëri, ose 31%, më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022, i cili njihet si viti më i mirë ndonjëherë në bilanc shifrash. | | |
| 65. | 10.08.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1. A është hequr nga fondi pyjor/kullosor sipërfaqja prej 0.47 ha në Bashkinë e Tropojës, qarku Kukës ku shoqëria “********” tashmë ka nisur veprimtarinë e prodhimit të asfalt-betonit? | 22.08.2023 | 1. A është hequr nga fondi pyjor/kullosor sipërfaqja prej 0.47 ha në Bashkinë e Tropojës, qarku Kukës ku shoqëria “*******” tashmë ka nisur veprimtarinë e prodhimit të asfalt-betonit?<br>-Nuk është kryer asnjë procedurë për heqje nga fondi pyjore.<br>2. Nëse kjo sipërfaqe nuk është hequr nga fondi pyjor, a ka bërë kërkesë shoqëria “*****” për heqjen e kësaj sipërfaqeje nga fondi pyjor?<br>Shoqëria ***** nuk ka bere asnjë kërkesë për heqje nga fondi pyjor.<br>3. A ka ende leje aktive mjedisore shoqëria “*****”?<br>Jo nuk ka leje mjedisore aktive. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2.Nëse kjo sipërfaqe nuk është hequr nga fondi pyjor, a ka bërë kërkesë shoqëria "******" për heqjen e kësaj sipërfaqeje nga fondi pyjor?<br><br>3. A ka ende leje aktive mjedisore shoqëria "******"? | | | | |
| 66. | 10.08.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me: Më 5 dhjetor 2022 është nënshkruar një marrëveshje mes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe<br><br>Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor me qëllim promovimin e | 23.08.2023 | Në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për platformën e-transport.al ju informojmë se jemi përgjigjur kërkesave që na ka ardhur nga kjo drejtori ne lidhje me dhënien e informacioneve për kalendarin festiv te Turizmit. Ky informacion konsistonte në vendet dhe datat kur do zhvillohen aktivitetet turistike. Gjithashtu është publikuar dhe linku I kësaj platforme ne faqen zyrtare te Ministrisë: https://turizmi.gov.al/ në rubrikën "Turizmi". | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | platformës“eTrans port”.<br><br>Cilat janë disa nga format që keni ndërmarr për ta promovuar këtë platformë deri më tani? | | | | |
| 67. | 18.08.2023 | Mbi ankimin ndaj refuzimit per dhënie te informacionit dhe kopje te dokumentacionit dhe kopje te dokumenteve zyrtaere | | Në proces | | |
| **68.** | **25.08.2023** | Kërkesë për informacion ne lidhje me ecurinë e miratimit te akteve nënligjore te parashikuara ne ligjin Nr. 10 006, DATË 23.10.2008, “PËR MBROJTJEN E FAUNËS SË EGËR”, TË NDRYSHUAR. | **07.09.2023** | **Jane miratuar:**<br><br>16.2 Qendrat e shpëtimit<br><br>2. Organizimi dhe funksionimi i qendrave të shpëtimit, që krijohen nga persona fizikë e juridikë, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.<br><br>**Neni 26** Koleksionet zoologjike pika 2. Ministri miraton rregulloren e trajtimit të llojeve të faunës së egër në zooparqe apo në mjedise të tjera, ku individët i ekspozohen publikut. | **Përfunduar** | **0** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Konkretisht, do t'ju isha shume mirënjohës nëse me përditësoni ne lidhje me miratimin ose planifikimin e:<br><br>16.2 Qendrat e shpëtimit<br><br>2. Organizimi dhe funksionimi i qendrave të shpëtimit, që krijohen nga persona fizikë e juridikë, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.<br><br>Neni 23 Tarifa e përdorimit<br><br>Personat fizikë dhe juridikë, që përdorin lloje të faunës së egër, në | | Miratuar<br><br>Neni 33 Inventarizimi i faunës së egër pika 3. Ministri miraton udhëzimin për kërkesat dhe rregullat e kryerjes së procesit të inventarizimit, për teknikat e metodat që përdoren, për formatin e dokumentacionit të inventarizimit e për publikimin e rezultateve të tij, të cilat janë të njëjta me ato të përcaktuara në direktivat e BE-së.<br>Miratuar<br><br>**Do te miratohen:**<br><br>Neni 23 Tarifa e përdorimit<br><br>Personat fizikë dhe juridikë, që përdorin lloje të faunës së egër, në përputhje me pikën 1 të nenit 21 të këtij ligji, paguajnë tarifën e përdorimit. Masa e kësaj tarife për çdo lloj përdorimi dhe mënyra e pagimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.<br><br>Neni 12.2 Kompensimi i dëmit<br><br>2. Ministri, në bashkëpunim me Ministrin e Financave, miratojnë udhëzimin për rregullat e vlerësimit dhe të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga llojet e faunës së egër, sipas pikës 1 të këtij neni.<br><br>Neni 13 Ruajtja dhe përshtatja<br><br>2. Përjashtimi nga dispozitat e mësipërme justifikohet vetëm në rastet kur nuk ka zgjidhje tjetër të kënaqshme, kur ka të bëjë me | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përputhje me pikën 1 të nenit 21 të këtij ligji, paguajnë tarifën e përdorimit. Masa e kësaj tarife për çdo lloj përdorimi dhe mënyra e pagimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.<br><br>Neni<br>12.2 Kompensimi i dëmit<br><br>2. Ministri, në bashkëpunim me Ministrin e Financave, miratojnë udhëzimin për rregullat e vlerësimit dhe të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga llojet e faunës së egër, sipas pikës 1 të këtij neni. | | një numër të kufizuar e rreptësisht të kontrolluar dhe kur përdoret:<br>a) në interes të shëndetit dhe sigurisë publike, ose për të parandaluar dëmtime serioze në të mbjella, në bagëti, në pyje, në peshkim dhe ujëra, ose për të mbrojtur florën dhe faunën;<br>b) për qëllime kërkimore dhe edukative ose për ripopullimin apo rihyrjen e llojeve;<br>c) në interes të sigurisë ajrore.<br>3. Kriteret dhe rregullat për realizimin praktik të kërkesave të pikës 2 të këtij neni miratohen me udhëzim të ministrit.<br><br>Neni 14 Habitatet e mbrojtura të shpendëve pika 2. Territoret më të përshtatshme, nga pikëpamja e pranisë, gjendjes dhe nivelit të popullatave të llojeve të shpendëve të egër, veçanërisht vulnerabël, që janë subjekt i masave të veçanta ruajtëse të habitateve, shpallen zona veçanërisht të mbrojtura. Lista e llojeve të shpendëve të egër, veçanërisht vulnerabël, miratohet me urdhër të ministrit. Ky proces kryhet rast pas rasti, dhe nuk del vetem nje dokument pergjithesues.<br><br>Neni 30 Cirk me lloje të faunës së egër pika 2. Ministri miraton rregulloren për trajtimin e individëve të llojeve të faunës së egër që mbahen në cirk.<br><br>Neni 36 Programi i biomonitorimit pika 3. Rregullat dhe procedurat për hartimin e programit të biomonitorimit dhe për zbatimin e tij miratohen me udhëzim të ministrit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Neni 13 Ruajtja dhe përshtatja<br><br>2. Përjashtimi nga dispozitat e mësipërme justifikohet vetëm në rastet kur nuk ka zgjidhje tjetër të kënaqshme, kur ka të bëjë me një numër të kufizuar e rreptësisht të kontrolluar dhe kur përdoret:<br>a) në interes të shëndetit dhe sigurisë publike, ose për të parandaluar dëmtime serioze në të mbjella, në bagëti, në pyje, në peshkim dhe ujëra, ose për të mbrojtur florën dhe faunën;<br>b)për qëllime kërkimore dhe edukative ose për ripopullimin apo rihyrjen e llojeve;<br>c) në interes të sigurisë ajrore. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. Kriteret dhe rregullat për realizimin praktik të kërkesave të pikës 2 të këtij neni miratohen me udhëzim të ministrit.<br><br>Neni 14 Habitatet e mbrojtura të shpendëve<br><br>2. Territoret më të përshtatshme, nga pikëpamja e pranisë, gjendjes dhe nivelit të popullatave të llojeve të shpendëve të egër, veçanërisht vulnerabël, që janë subjekt i masave të veçanta ruajtëse të habitateve, shpallen zona veçanërisht të mbrojtura. Lista e llojeve të shpendëve të egër, veçanërisht vulnerabël, | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | miratohet me urdhër të ministrit.<br><br>Neni<br>26 Koleksionet zoologjike<br><br>2. Ministri miraton rregulloren e trajtimit të llojeve të faunës së egër në zooparqe apo në mjedise të tjera, ku individët i ekspozohen publikut.<br><br><br>Neni 30 Cirk me lloje të faunës së egër<br><br>2. Ministri miraton rregulloren për trajtimin e individëve të llojeve të faunës së egër që mbahen në cirk.<br><br>Neni 33 Inventarizimi i faunës së egër | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. Ministri miraton udhëzimin për kërkesat dhe rregullat e kryerjes së procesit të inventarizimit, për teknikat e metodat që përdoren, për formatin e dokumentacionit të inventarizimit e për publikimin e rezultateve të tij, të cilat janë të njëjta me ato të përcaktuara në direktivat e BE-së.<br><br>Neni 36 Programi i biomonitorimit<br><br>3. Rregullat dhe procedurat për hartimin e programit të biomonitorimit dhe për zbatimin e tij miratohen me udhëzim të ministrit. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **69.** | **28.08.2023** | Kërkesë për informacion: 1-Sa është fondi i shpenzuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmin për promovimin e turizmit për vitet 2022- 2023<br><br>2- Ju lutem na vini ne dispozicion te dhëna për shpenzimet qe janë kryer për promovimin e turizmin ne vitet 2022-2023 për; Fushata promovuese, reklama, emisione, artikuj, blogere<br><br>3- Emrat e mediave, personave dhe agjencive qe janë paguar | **15.09.2023** | Bazuar në misionin, vizionin dhe politikat strategjike të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, fusha e Turizmit adreson gjithmonë dhe më shumë nevojën për zhvillimin dhe promovimin e duhur nëpërmjet kanaleve dhe formave inovative të prezantimit, që synojnë të vendosin Shqipërinë në pozicionin e saj të duhur të hartës Turistike Ballkanike dhe më gjerë.<br>Mbështetur në objektivin për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në mbrojtje dhe ruajtje të traditave dhe vlerave kulturore, historike, natyrore etj., në mbështetje të Ligjit nr. 93/2015 *“Për turizmin”*, i ndryshuar si dhe kuadrit nënligjor në fuqi, me qëllim promocioni mediatik janë mbështetur projektet:<br><br>Dokumentari “Thesaret e Shqipërisë” nga Bettany Hughes në BBC: në vlerën 28.705.002 lekë.<br>Projekti i Fondacionit “******” në vlerën 8.000.000 lekë.<br>Projekti i *******” në vlerën 4.000.000 lekë.<br><br>Promovimi për një turizëm të diversifikuar, gjithëvjetor dhe që gjen shtrirje në audienca dhe target grupe të gjera brenda dhe jashtë vendit, ka për qëllim rritjen e vlerës së shtuar dhe impaktit pozitiv të sektorit në zinxhirin e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. | **Perfunduar** | **0** |

**Shtator 2023**

| **Nr. (1)** | **Data e regjistrimit të kërkesës (2)** | **Objekti (3)** | **Data e kthimit të përgjigjes (4)** | **Përgjigja(5)** | **Statusi i kërkesës (6)** | **Tarifa (7)** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **70.** | **4.09.2023** | Kërkese për informacion ne lidhje me relacionet e projekt vendimeve: vkm nr.500 date 24.8.2023 “Për përjashtimin nga ndalimi i gjuetisë, për qëllime shkencore pasvaksinale, të kafshëve të vaksinuara, në kuadër të projektit IPA 2020, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjes së | | Në proces | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | tërbimit-faza iv”<br><br>VKM nr. 462 date 26.7.2023 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 417, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit"”<br><br>Vkm nr. 463 date 26.7.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 419, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", të ndryshuar”<br><br>Vkm nr. date.315 24.5.2023 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të pasurive me nr.178/44, 152/43 dhe 182, në zonën | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kadastrale nr.1522”<br><br>Vkm nr.316 date 24.5.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 22, datë 12.1.12018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij", të ndryshuar”<br><br>Vkm nr. 339 date 31.5.2023 “Për një shtesë në vendimin nr.1156, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për | | | | |

<table>
<tr><td></td><td></td><td>përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre’”’</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>71.</td><td>11.09.2023</td><td>Kërkese për informacion ne lidhje me: 1- Sa është numri i fidanëve që janë mbjellë për ripyllëzimet duke filluar nga viti 2014 e deri më tani? Të dhënat për numrin e fidanëve të mbjellë të jenë të ndarë sipas viteve… 2- Sa është fondi i shpenzuar për ripyllëzimin që nga viti 2014 e deri më tani? 3- A ka ministria</td><td>22.09.2023</td><td>1.Sa është numri i fidanëve që janë mbjellë për ripyllëzimet duke filluar nga viti 2014 e deri me tani? Të dhënat për numrin e fidanëve të mbjellë të jenë të ndarë sipas viteve…<br>Përgjigje: Duke qenë se pyllëzimet fillojnë në muajin dhjetor dhe mbyllen në muajin mars të vitit pasrendës, koncepti i vitit përkon me atë të periudhës, të cilat jepen në tabelen në vijim.
<table>
<tr><td>Nr.</td><td>Periudha</td><td>Numri i fidanëve të mbjellë</td></tr>
<tr><td>1</td><td>2014 – 2015</td><td>3 470 000</td></tr>
<tr><td>2</td><td>2015 - 2016</td><td>2 167 000</td></tr>
<tr><td>3</td><td>2016 – 2017</td><td>987 000</td></tr>
<tr><td>4</td><td>2017 – 2018</td><td>1 035 000</td></tr>
<tr><td>5</td><td>2018 – 2019</td><td>941 500</td></tr>
<tr><td>6</td><td>2019 – 2020</td><td>874 000</td></tr>
<tr><td>7</td><td>2020 – 2021</td><td>1 016 449</td></tr>
<tr><td>8</td><td>2021 – 2022</td><td>944 700</td></tr>
<tr><td>9</td><td>2022 – 2023</td><td>Ne process validimi i të dhënave</td></tr>
</table>
2.Sa është fondi i shpenzuar për ripyllëzime që nga viti 2014 e deri me tani?.<br><u>Përgjigje:</u> Në total llogariten afërsisht 1.7 milion euro ose afërsisht 200 milionë lekë të destinuara për mbështetjen e projekteve të pyllëzimit.</td><td>Përfunduar</td><td>0</td></tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | një fidanishte të sajën apo i blen në privat fidanët e rinj? Nëse nuk ka fidanishte, ku i blen fidanët e rinj për mbjellje dhe cila është garancia që ato i përshtaten klimës së vendit tonë? Ka më shumë kosto ngritja e një fidanishtje shtetërore apo blerja e fidanëve në privat? 4- Në vitin 2009, ish kryeministri Berisha nisi të ashtuquajturin “projekti i ullirit”, që parashikonte fillimisht mbjelljen e 20 milion rrënjë ullinj e arrorë, premtim që më pas shkoi në 50 | | **3.A ka ministria një fidanishte të sajën apo i blen në privat fidanët e rinj? Nëse nuk ka fidanishte, ku i blen fidanët e rinj për mbjellje dhe cila është garancia që ato i përshtaten klimës së vendit tonë? Ka më shumë kosto ngritja e një fidanishteje shtetërore apo blerja e fidanëve në privat?**<br>**<u>Përgjigje:</u>** Ashtu sikurse mund të jeni informuar, në sajë të reformës territoriale administrative, fondi pyjor që nga viti 2016 ka kaluar në administrim dhe pronësi të pushtetit vendor. Sa më sipër ministria nuk ka një fidanishte të sajën.<br>Blerja e fidanëve të rinj për mbjellje nuk është detyrim i ministrisë, por i institucioneve respektive që administrojmë e planifikojnë punime mbi fondin pyjor. Gjithsesi për informacion më të detajuar në funksion të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se fidanët e rinj sigurohen nga subjekte vendase të licensuara të cilat merren me prodhimin e fidanëve, të certifikuar për këtë qëllim.<br><br>**4.Në vitin 2009, ish kryeministri Berisha nisi të ashtuquajturin “projekti i ullirit”, që parashikonte fillimisht mbjelljen e 20 milion rrënjë ullinj e arrorë, premtim që më pas shkoi në 50 mln rrënjë ullinj. Sa ka qenë realizimi i këtij projekti.**<br>**<u>Përgjigje:</u>** Në lidhje me këtë kërkesë sugjerojmë që pyetjen Tuaj t’ia adresoni Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.<br>**5.Cilat janë projektet që parashikohet të aplikohen në vitet në vijim në rritjen e numrit të pemëve të mbjella? Sa është fatura financiare për zbatimin e këtij plani?**<br>**<u>Përgjigje:</u>** Në lidhje me këtë pyetje theksojmë se është hartuar nga ana e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve “Plani Kombëtar për mbjellje drurësh pyjorë dhe pyllëzime për periudhën 2023-2030”. Në kuadër të këtij plani, parashikohen që në 10 vitet në vijim të mbillen rreth 20.5 milion fidanë, ose të kemi një shtesë sipërfaqeje të fondit pyjor prej 8273 hektarë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mln rrënjë ullinj. Sa ka qenë realizimi i këtij projekti?<br>5- Cilat janë projektet që parashikohet të aplikohen në vitet në vijim në rritjen e numrit të pemëve të mbjella? Sa është fatura financiare për zbatimin e këtij plani? | | Kostoja financiare për arritjen e këtij objektivi është parashikuar rreth 33 milion euro ose 3.7 miliardë lekë. | | |
| 72. | 13.09.2023 | Kërkesa për informacion ne lidhje me: Fondacioni "*****" ka përfituar një fond me vlere 2.400.000 leke nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ( dt. regjistrimit 02.08.2023). Shuma e mësipërme ka kaluar ne llogarinë e | | Bazuar në misionin, vizionin dhe politikat strategjike te Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, fusha e Turizmit adreson gjithmonë dhe më shumë nevojën për zhvillimin dhe promovimin e duhur nëpërmjet kanaleve dhe formave inovative te prezantimit, që synojnë të vendosin Shqipërinë në pozicionin e saj të duhur te hartës Turistike Ballkanike dhe më gjerë.<br>Mbështetur në objektivin për zhvillimin e një turizmi te qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në mbrojtje dhe ruajtje të traditave dhe vlerave kulturore, historike, natyrore etj., në mbështetje te Ligjit nr. 93/2015 "Për turizmin ", i ndryshuar si dhe kuadrit nënligjor ne fuqi.<br>Ministria Përgjegjëse për Turizmin dhe Mjedisin, nga fondi buxhetori miratuar çdo vit, financon projekte edukimi, promovimi dhe studime apo modele produktesh turistike në ndihme të zhvillimit të turizmit, të paraqitura nga persona fizike dhe juridike, vendas e të huaj, në funksion të realizimit të | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | fondacionit me 07 gusht 2023 (dt. ekzekutimit 07.08.2023), për "Projektin pushime on Top".<br><br>CNA kërkon arsyet pse është dhëne ky fond nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për një projekt ne një televizion privat kombëtar? Mbi çfarë baze ligjore është dhëne një fond i tille? Cilin interes publik keni përmbushur? Sa projekte te tjera i janë dhëne këtij fondacioni përgjatë tre viteve te fund it dhe cila është shuma e përfituar? | | misionit strategjik: "Shqipëria, një destinacion mikpritës, tërheqës dhe autentik; për zhvillim i qëndrueshëm i potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit".<br>Konkretisht, bazuar në Vendimin e Këshillit te Ministrave nr. 281, date 13.04.2016 "Për përcaktimin e kritereve dhe ofertave të kërkesë propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit", subjekti "Fondacioni Dritan Hoxha" me numër NIPT L 11321451 L, është aplikues në statusin e një organizate jo-fitimprurëse.<br>Promovimi për një turizëm te diversifikuar, gjithë vjetor dhe qe gjen shtrirje në audienca dhe target grupe të gjëra, ka për qellim rritjen e vlerës së shtuar dhe impaktit pozitiv të sektorit në zinxhirin e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit tonë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 73. | 13.09.2023 | 1- A ka kryer Institucioni juaj matje të cilësisë së ajrit në vendin tonë nga viti 2013 deri në vitin 2023?<br><br>Nëse po kërkoj një kopje të këtyre raporteve.<br><br>2-Cilat qytete kanë nivelin e ndotjes mbi normën e vendosur nga BE dhe OBSH?<br><br>AKM kryen monitorim të ajrit urban duke u bazuar në normat e BE.<br><br>3-Si është kryer/kryhet | 20.09.2023 | Kthyer përgjigje nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | matja e cilësisë së ajrit?<br><br>4-Sa pajisje, stacione të matjes së cilësisë së ajrit ka aktualisht në vendin tonë dhe ku janë të vendosura?<br><br>5--Shqipëria ka një ligj për mbrojtjen e mjedisit. Ligji 162/2014, “Për mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis”. Ligji parashikon që qeveria duhet të bëjë matje, dhe gjithashtu duhet edhe të informojë qytetarët. Nga viti 2013 deri në vitin aktual | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2023 sa herë janë informuar qytetarët? Ku janë bërë këto lajmërime? Kërkoj gjithashtu një kopje të informacionit që ju është shpërndarë qytetarëve.<br><br>6--Sa është vlera e investimeve të kryera për matjen ë cilësisë së ajrit në vendin tonë nga viti 2013 deri në vitin 2023? (specifikisht sipas secilit vit) | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 74. | 20.09.2023 | Kërkese për informacion ne lidhje me: Komuniteti i njësisë administrative Suç në Bashkinë Klos është organizuar kundër hidrocentraleve “Lusa1&2” në përroin e Lusës. Aktualisht, ata kanë mbledhur 1000 firma kundër, ndërsa “******” ka marrë dakordësinë e 15 banorëve për ndërtimin e këtyre veprave, në mungesë të përfaqësuesve të Bashkisë Klos. Më herët, banorët kanë refuzuar shfrytëzimin e këtij përroi në | | Ne proces | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dy dëgjesa të tjera.<br><br>Aktualisht, AMBU-ja ka dhënë leje për shfrytëzimin e burimeve ujore ndërsa Bashkia Klos është shprehur kundër këtyre hidrocentraleve.<br><br>1. Cili është qëndrimi i Ministrisë së Mjedisit sa i përket kësaj çështjeje dhe cilat do të jenë masat që do të merrni mbi problematikën në fjalë?<br><br>2. A do t'i japë leje mjedisi Ministria "*****" për ndërtimin e këtyre hidrocentraleve | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | që prekin ujin e pijshëm dhe atë vaditës? | | | | |
| 75. | 21.09.2023 | Kërkese për informacion ne lidhje me: Cilat kanë qenë fushatat marketing të financuara nga buxheti i shtetit këto 10 vitet e fundit për të marketuar Shqipërinë dhe turizmin në Shqipëri në botë?<br><br>· Sa kanë qenë kostot financiarë të këtyre fushatave?<br><br>· A keni bërë vlerësim të efektivitetit të këtyre fushatave, si kanë rezultuar, | | Ne proces | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | cilat janë të dhënat e fushatave në këtë drejtim dhe nëse mundet konkretisht për shtrirjen e secilës<br><br>· Cila ka qenë fushata më e sukseshme dhe si e keni matur suksesin e kësaj fushatë në arenën ndërkombëtare?<br><br>· Sa e fortë është marka shtet e Shqipërisë sot në botë në krahasim me 10-vite më parë dhe si mund ta argumentoni këtë kalim<br><br>· Si e vlerësoni performancën e fushatës Be Taken By | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Albania dhe cili ka qenë roli i Ministrisë në këtë fushatë?<br><br>· Sa është buxheti vjetor i ministrisë me qëllim reklamimin apo marketimin e Shqipërisë dhe produkteve Made in Albania në tregjet e huaja të turizmit? | | | | |
| 76. | 21.09.2023 | Kërkese për informacion ne lidhje me: Sa është fondi i shpenzuar nga Agjencia Kombëtare e Turizmit për promovimin e turizmit për vitet 2022 dhe 2023 | | Ne proces | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ju lutem na vini ne dispozicion te dhëna për shpenzimet qe janë kryer për promovimin e turizmin ne vitet 2022-2023 për; Fushata promovuese, reklama, emisione, artikuj, blogere, dhe çdo projekt apo aktivitet tjetër qe ka pasur si synim promovimin e turizmit.<br><br>3- Emrat e mediave, personave dhe agjencive qe janë mbështetur financiarisht nga kjo agjenci për projekte, artikuj, video, reklama, apo çdo forme tjetër qe është përdorur për te | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | provuar turizmin<br><br>4- Emërtimet e projekteve te financuara dhe ju lutem na vini ne dispozicion linqe, foto ose dokumente qe lidhen me secilin projekt | | | | |
| 77. | 21.09.2023 | Kërkese për informacion në lidhje me: mbi gjininë e 1 administratori/e nën moshën 29 vjeç, që është shpallur fitues. | 27.09.2023 | Gjinia e administratorit nën moshën 29 vjeç që është shpallur fitues është femër. | Përfunduar | 0 |
| 78. | 26.09.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: Kërkesën e subjektit ***** ne lidhje me procesin e | | Ne proces | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shfuqizimit te lejes mjedisore. | | | | |
| 79. | 27.09.2023 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: Kjo gazete është e re ne tregun shqiptar dhe ka synim promovimin e turizmit ne Nikaj-Mertur, një zone e pa shfrytëzuar, por me potenciale te jashtëzakonshme me vlera te trashëgimisë kulturore kombëtare! Ju drejtohem për një informacion zyrtar lidhur me ketë zone te veriut te Shqipërisë, Nikaj-Merturin. A keni ne arkivat tuaja ndonjë projekt zhvillimi qe përmend këtë zone? A ka plane zhvillimi ne te ardhmen për turizmin ne Alpet Shqiptare, | | Ne proces | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | veçanërisht ne Nikaj-Mertur dhe 12 fshatrat e saj? | | | | |
| | | | | | | |

**Shënim:**

Regjistri përditësohet çdo tre muaj.

(1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.

(2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.

(3) Identifikohet lloji i kërkesës.

(4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

***(**Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale")*

(5) Ndihmon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit.

(6**)** Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.